



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova -
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate



SOC
2022 TA

KOSOVË

VLERËSIMI I KËRCËNIMIT NGA KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMET E RËNDA



Tabela e Përmbajtjes

HYRJA	6
TRAFIKIMI ME NARKOTIKË	7
Marihuana.....	13
Kokaina.....	15
Heroina.....	17
TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE	21
Shfrytëzimi seksual i fëmijëve.....	25
KONTRABANDIMI ME MIGRANTË	28
Kontrabandimi me migrantë kosovarë.....	32
Kontrabandimi me migrantët e huaj.....	33
KRIMET KIBERNETIKE	36
Format dhe metodat e krimeve kibernetike.....	38
KORRUPSIONI	41
Shpëlarja e parasë.....	45
KONTRABANDA ME MALLRA	47
Kontrabandimi i produkteve të duhanit.....	48
Kontrabandimi i derivateve të naftës dhe vajrave.....	50
Kontrabandimi i tekstit.....	51
Kontrabandimi i pijeve alkoolike dhe jo-alkoolike.....	51
Rrugët e kontrabandimit të mallrave të konsumit të përgjithshëm.....	52
VEPRAT PENALE QË NDËRLIDHEN ME TË DREJTËN E AUTORIT DHE MALLRAT E FALSIFIKUARA	53
TRAFIKIMI ME ARMË	57
Armët ilegale dhe municioni i konfiskuar.....	60
KËRCËNIMET HIBRIDE	63
KRIMET MJEDISORE	65
LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	68



MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS

Z. Samedin MEHMETI

Kam nderin dhe kënaqësinë të prezantoj dokumentin strategjik “SOCTA 2019 – 2021”, i hartuar dhe punuar nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me partnerët tanë që kontribuojnë në ruajtjen dhe sundimin e ligjit.

Raporti strategjik “SOCTA” është ndër dokumentet më të rëndësishme strategjike në nivel vendi, i cili ofron informacione të analizuara lidhur me kërcënimet nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar, me të cilat mund të përballen institucionet e vendit.

“SOCTA” është një dokument strategjik, i cili përshkruan faktorët dhe mjedisin e krimit të organizuar në Kosovë dhe jo vetëm.

Dokumenti “SOCTA” është një burim thelbësor për vendimmarrësit e lartë institucionalë, i cili thekson se shumica e formave të krimit të organizuar dhe atij të rëndë, në ditët e sotme kanë shtrirje globale dhe janë gjithnjë e më komplekse.

Ky dokument bazohet në raportet dhe statistikat zyrtare të marra nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, institucione të tjera relevante për zbatim të ligjit, informata inteligjente, agjenci të pavarura, organizata joqeveritare nga burimet e hapura etj.

Nga ky dokument dalin rekomandime të bazuara në analiza të thella të kërcënimeve kryesore nga krimet e rënda dhe ato të organizuara me të cilat është përballur dhe pritet të ballafaqohet në vijim Republika e Kosovës.

Ekzistenca e vazhdueshme e krimit të organizuar ruhet edhe përmes metodave të korrupsionit të zyrtarëve publikë, përdorimit të frikësimit, shantazhit, kërcënimit ose forcës fizike etj.

Krimi i organizuar është ndër kërcënimet më të mëdha me të cilat përballemi sot, i cili është një fenomen kompleks që konsiderohet një kërcënim serioz për sigurinë e vendit tonë dhe më gjerë.

Krimi i organizuar po bëhet gjithnjë e më profesional dhe kjo u tregua edhe në raportin e fundit të SOCTA-s nga EUROPOL- i, i publikuar në vitin 2021.

Lufta kundër krimit të organizuar kërkon një përpjekje të përbashkët dhe profesionalizëm nga të gjithë partnerët e fushës në zbatimin e ligjit.

Sfidat që paraqet krimi i organizuar për qeverisjen demokratike të vendit tonë dhe sigurinë publike, kërkojnë përgjigje të politikave në nivel kombëtar, rajonal dhe atë global.

Krimi i organizuar pengon zhvillimin ekonomik të shtetit tonë dhe krijon pengesa në anëtarësimin e vendit drejt mekanizmave ndërkombëtarë.

Menaxhmentit të lartë të Policisë së Kosovës çdo ditë gjatë detyrave dhe përgjegjësive u kërkohet të marrin vendime, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve dhe në sigurinë e vendit në përgjithësi.

Duke pasur një grup të qartë prioritetesh dhe shpërndarje të mirë të burimeve njerëzore dhe materiale, konsideroj se ky dokument është çelës për efektivitet policor, veçanërisht në një botë gjithnjë e më të globalizuar.

Bazuar në qëllimin e këtij dokumenti mbetet detyrë e menaxhmentit të lartë të Policisë që të hartojnë plane të caktuara për përmbushjen e rekomandimeve që dalin nga ky dokument dhe besoj që ky vlerësim të jetë i dobishëm për forcimin e bashkërendimin tonë drejt përpjekjeve për ta luftuar krimin e organizuar dhe krimet e rënda.

Në fund falënderojmë të gjitha agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit, të gjitha institucionet e tjera shtetërore, OJQ-të, dhe IPA-2019 CSCWB “Countering Serious Crime in the Western Balkans - Luftimi i Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor”, për kontributin e tyre të vlefshëm në hartimin e këtij dokumenti strategjik.

Z. Samedin MEHMETI

Drejtore i përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Krimi i organizuar përbën kërcënim serioz ndaj sigurisë së brendshme dhe asaj ndërkombëtare. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme në përputhshmëri me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore, sidomos në kushtet aktuale të globalizimit dhe dinamikës së tyre të vazhdueshme drejt sofistikimit të mënyrës së operimit.

Rrjetet ndërkombëtare kriminale, po ashtu kanë fleksibilitet që shpejt dhe me kreativitet t'u adaptohen përpjekjeve të organeve për zbatimin e ligjit. Këto grupe janë në gjendje që me sukses t'i shmangen përpjekjeve të organeve për zbatim të ligjit.

Sikurse edhe në vendet tjera të rajonit por edhe të Evropës, grupet e krimit të organizuar në Kosovë janë duke e zgjeruar rrjetin e tyre gjithnjë e më shumë si brenda ashtu edhe jashtë kufijve me lloje të ndryshme të krimeve të kombinuara me rrezikshmëri gjithnjë e më të madhe për sigurinë.

Kosova vazhdon të jetë vend tranzit i disa llojeve të veprave të krimeve të rënda dhe të organizuara, ndërsa tani ka një tendencë në rritje të jetë vend destinacioni për disa lloje të këtyre krimeve siç janë drogat, por edhe të disa rasteve të kontrabandimit të migrantëve e trafikimit me njerëz. Prandaj lufta kundër krimit të organizuar kërkon ngritje të kapaciteteve në vazhdimësi si dhe bashkëpunim më të madh ndër-institucional ndër- rajonal dhe ndërkombëtar.

Grupet e krimit të organizuar karakterizohen me aftësi të përshtatjes së shpejtë të tyre në kushte dhe rrethana të reja duke gjetur hapësirë për realizimin e fitimeve të mëdha, duke ushtruar ndikim në institucionet dhe rendin juridik të shtetit dhe kjo situatë është shumë më e rrezikshme në vendet në zhvillim ku bën pjesë edhe Kosova.

Institucionet e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh trendet dhe kërcënimet nga format e krimit të rëndë dhe krimit të organizuar, kanë identifikuar nevojën që të hartohet ky dokument strategjik për vlerësimin e trendëve aktualë dhe parashikimin e vlerësimit në të ardhmen nga këto forma të kriminalitetit (SOCTA).

Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është të ofrojë një pasqyrë të zhvillimeve sa i përket kërcënimeve që vijnë ndaj vendit tonë nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda, me qëllim të caktimit të prioriteteve për aktivitetet që duhet ndërmarrë në minimizimin e kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët në Republikën e Kosovës.

Të dhënat e siguruara për hartimin e këtij dokumenti janë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të dhënat zyrtare nga Policia e Kosovës, të dhënat nga institucionet e tjera relevante, agjencive të pavarura dhe atyre të specializuara, OJQ të ndryshme, por edhe të dhëna nga burimet e hapura, duke përfshirë edhe hulumtime të ndryshme nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.

TRAFIKIMI ME NARKOTIKË

Prodhimi, trafikimi me lëndë narkotike dhe përdorimi i paligjshëm i tyre vazhdon të mbetet ndër format më të theksuara të përfshirjes së grupeve të organizuara kriminale në Republikën e Kosovës. Përkundër angazhimit të organeve të sigurisë në luftimin dhe parandalimin e trafikimit me narkotikë, situata e përgjithshme në fushën e narkotikëve vazhdon të mbetet një kërcënim serioz për shoqërinë tonë, edhe pse gjatë dy viteve të fundit është shënuar një ulje e ndjeshme e rasteve të hapura.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht që ka edhe ulje të sasisë së drogave në tregun kosovar, por mund të jetë edhe si pasojë e masave kufizuese anti COVID të ndërmarra si nga Institucionet e Republikës së Kosovës, ashtu edhe nga vendet e tjera.

Viti	Rastet	Trafikim	Posedim	Kultivim	Operacione
2016	888	198	605	85	783
2017	1368	239	1095	33	788
2018	1866	283	1574	9	1174
2019	1450	269	1159	22	1014
2020	1006	170	802	33	552
2021	726	218	478	29	406

Numri i rasteve të narkotikëve të iniciuara, sipas veprës i ndarë sipas periudhave 2016-2018 dhe 2019-2021

Republika e Kosovës edhe më tutje vazhdon të shfrytëzohet si vend transit nga trafikantët e drogave të llojeve të ndryshme. Pjesa më e madhe e narkotikëve është e destinuar për në tregun e jashtëm, kryesisht me destinacion vendet e Evropës Perëndimore, (Austri, Gjermani dhe Zvicër). Kjo kryesisht si rezultat i depërtimit më të lehtë në treg, por edhe si rezultat i strukturës së grupeve të organizuara kriminale, që shpeshherë është i ndërlidhur edhe sipas lidhjeve me ndonjë nga familjarët e tyre në diasporë.

Një sasi e konsiderueshme e narkotikëve është e destinuar për tregun e brendshëm, përkatësisht për përdorimin e brendshëm.

Origjina e lëndëve narkotike, prej nga furnizohen grupet e organizuara kriminale nga Kosova mbetet pothuajse e njëjtë, me Turqinë që vazhdon të jetë vendi kryesor i furnizimit me heroinë, ndërsa Shqipëria për lëndët tjera narkotike, siç janë kokaina dhe kanabisi.



Foto nga një prej operacioneve të Policisë së Kosovës kundër narkotikëve

Marihuana dhe kokaina, janë dy substancat narkotike që kanë shënuar tendencë të rritjes së trafikimit, por edhe përdorimit në të gjithë territorin e Kosovës, kryesisht tek të rinjtë



Foto nga një prej operacioneve të Policisë së Kosovës kundër narkotikëve

dhe deri tek moshat e mitura.

Sipas të dhënave nga Klinika e Psikiatrisë pranë QKUK-së, moshë mesatare e personave të trajtuar në këtë klinikë lidhur me përdoruesit e marihuanës është 13-18 vjeçare¹.



Foto nga operacioni i konfiskimit të 400 kg. kokainë – operacioni “Adriatiku”

Sa i përket heroinës, sipas statistikave policore, vërehet një rënie e përdorimit të saj në vendin tonë në krahasim me vitet paraprake, kur ishte substanca e dytë më e popullarizuar.

Viti	Heroinë	Marihuanë	Hashash	Kokainë
2016	0.084 kg.	1146.9 kg.	0	0.168 kg.
2017	0.391 kg.	1908.17 kg.	0.520 kg.	0.711 kg.
2018	119 kg.	979.8 kg.	0.011 kg.	1.5 kg.
2019	7.7 kg.	824.2 kg.	25 kg.	1.58 kg.
2020	8.9 kg.	256.7 kg.	0.749 kg.	2 .66kg.
2021	3.6 kg.	499.5 kg.	0.026 kg.	414.95 kg.

Sasia e drogave kryesore të konfiskuara sipas periudhave 2016-2018 dhe 2019-2021

Sipas tabelës së lartcekur, krahasuar me periudhën 2016 – 2018, gjatë periudhës 2019-2021, vërehet qartë trendi i vazhdueshëm në rënie i konfiskimeve të heroinës por edhe të marihuanës, megjithatë e kundërta e kësaj paraqitet me kokainën, ku shihet një trend i vazhdueshëm në rritje, që ka kulmuar në vitin 2021, me konfiskimin e 400 kg. kokainë në një rast të vetëm i cili ka ardhur nga Brazili, konfiskimi i së cilës është rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar.

¹ Intervista e daktreshës së Klinikës së Psikiatrisë pranë QKUK, Vjollca Ramiqi: <https://albanianpost.com/kosove-nga-mosha-13-deri-18-vjec-raste-te-varesise-nga-droga-viti-2021-shenon-rritje-te-perdorimit/>


Kur jemi te bashkëpunimi ndërkombëtar, nënshkrimi i marrëveshjes së punës me EUROPOL-in në vitin 2020 dhe nënshkrimi i tri protokolleve shtesë, si dhe krijimi i mundësisë për dërgimin e ndërlidhësit policor kosovar në selinë e kësaj organizate, tashmë ia ka bërë të mundur Policisë së Kosovës të shkëmbejë informacionet në mënyrë më të sigurt me EUROPOL-in, vendet e BE-së dhe të rajonit, si dhe të kontribuojë në mënyrë më të shpejtë dhe më të drejtpërdrejtë, në përpjekjet e përbashkëta në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar.

Përveç këtyre drogave kryesore, në vendin tonë konsumohen dhe frekuentojnë edhe substanca të tjera narkotike, si p.sh. hashishi, ekstazi, amfetamina, tramadoli etj.

Sipas të dhënave të inteligjencës, në trend është edhe një lloj i veçantë i kanabisit, mjaft i rrezikshëm për shëndetin, i quajtur "Skunk"², i cili sillet nga Serbia në Kosovë, si dhe mund të gjendet kryesisht në veri të Kosovës.

² Të dhëna nga Inteligjenca

Në hartën e mëposhtme të publikuar nga “Globalinitiative.net”, mund të shihen drejtimet e drogave kryesore për në Kosovë dhe nga Kosova për në shtetet fqinje.



Harta e lëvizjes së drogave në shtetet e Ballkanit, e marrë nga globalinitiative.net

Përdorimi i lëndëve narkotike, e sidomos nga moshat e reja, vazhdon të mbetet shqetësim serioz.

Edhe pse nuk kemi informata të sakta mbi numrin e përdoruesve të drogave, duke u bazuar në trendin aktual, por edhe të dhënat e siguruar nga institucionet shëndetësore, si dhe hulumtimeve të ndërmarra nga shoqëria civile, vlerësohet se numri i përdoruesve të drogave në Republikën e Kosovës sillet rreth 40,000³ përdorues, prej të cilëve 7000 – 9000, vlerësohet të jenë përdorues problematik, apo që kanë krijuar varësi ndaj drogave.

Sipas të dhënave nga institucionet shëndetësore publike, por edhe të qendrave që janë të angazhuara në programe të trajtimit me ‘metadon’ të përdoruesve të drogave, moshë mesatare e përdorimit të drogave është ulur ndjeshëm, që aktualisht është moshë 16.2, në krahasim me vitet paraprake, e sidomos me vitin 2008, kur moshë mesatare e përdoruesve të drogave sillej rreth moshës 21.4 vjeçare⁴.

Përveç rrezikut të shëndetit që paraqet përdorimi i lëndëve narkotike, tashmë të njohura dhe të dokumentuara shkencërisht, bazuar në të dhënat nga ekzaminimi i substancave të dyshuara narkotike, por edhe dëshmime nga vet personat e dyshuar si përdorues të lëndëve narkotike, ka raste që përzierja e lëndës narkotike me substanca të tjera të rrezikshme, rrezikon seriozisht shëndetin, por edhe jetën e përdoruesve.

Edhe pse për momentin nuk ka të dhëna të detajuara për përfshirjen e mundshme të përdoruesve të lëndëve narkotike në vepra të tjera penale, megjithatë sipas të dhënave të inteligjencës, një numër i konsiderueshëm i përdoruesve të lëndëve narkotike, me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare për blerjen e lëndëve narkotike, përfshihen në vepra të tjera penale, si vepra të dhunshme penale, dhunë familjare, vjedhje, grabitje etj.

Aktualisht nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e personave të vdekur nga mbidoza, apo edhe si rezultat i përdorimit të drogave të këqija (drogave me përzierje të rrezikshme).

Megjithatë sipas të dhënave nga OJQ “Labyrinth” vetëm gjatë viteve 2019 – 2021, nga lista e personave që janë trajtuar me programe të metadonit në këtë OJQ, janë identifikuar gjithsejtë 18 rasteve të vdekjeve të dyshimta nga mbidoza, apo edhe si rezultat i përdorimit të përzierjeve të drogave të rrezikshme.

³ Intervista e drejtorit të qendrës së OJQ “Labyrinth”, Safet BLAKAJ: <https://www.koha.net/arberi/299576/40-mije-perdorues-te-drogave-ne-kosove-shqetesuese-mosha-e-re-e-perdoruesve-te-kokaines/>

⁴ OJQ “Labyrinth” & Reparti i Psikiatrisë - QKUK

Marihuana



Viti	Marihuanë kg.
2016	1146.9 kg.
2017	1908.1 kg.
2018	979.8 kg.
2019	824.2 kg.
2020	256.7 kg.
2021	499.5 kg.

Konfiskimi i marihuanës në vite i shprehur në kilogram

Marihuana, vazhdon të jetë droga më e përhapur në Republikën e Kosovës. Duke u bazuar në trendin aktual, indikacionet janë se përhapja e saj do të jetë në ngritje në vitet e ardhshme.

Zbulimi i disa laboratorëve (fermave) për kultivimin e marihuanës në territorin e Kosovës, është një tregues i qartë, se përpos furnizimit nga Shqipëria, marihuana është duke u kultivuar edhe brenda vendit tonë dhe atë me një dinamikë të shtuar.

Grupet kriminale që merren me trafikim të marihuanës zakonisht janë divergjente, të përbëra nga nacionalitete të ndryshme dhe nuk kanë ndonjë organizim strukturor ashtu si grupet e tjera të njohura në nivel ndërkombëtar.

Shqipëria mbetet vendi kryesor ku trafikantët kosovarë furnizohen me marihuanë. 95 % e marihuanës së konfiskuar në Kosovë, ka ardhur nga Shqipëria. Në këtë aktivitet kriminal, ata bashkëpunojnë me furnizuesit nga Shqipëria dhe narkotikun e kalojnë përmes pikave kufitare të fshehur me mallra, apo edhe rrugëve malore. Në të shumtën e rasteve, trafikantët nga Shqipëria e sjellin drogën deri në vendin e caktuar në Kosovë sipas marrëveshjes, por ka raste kur trafikantët kosovarë shkojnë në Shqipëri dhe e blejnë marihuanën atje, me një çmim më të vogël dhe transportin për në Kosovë e bëjnë vet.

Sa i përket trafikimit të marihuanës nga Kosova për në disa nga shtetet e Evropës Perëndimore, zakonisht trafikantët përdorin metoda të sofistikuara dhe me kujdes zgjedhin persona të sigurt bazuar në lidhjet e tyre familjare apo shoqërore, persona këta me leje qëndrimi të ndonjë shteti evropian, të cilët pastaj e bëjnë transportimin zakonisht duke e fshehur në bunker special brenda veturave. Po ashtu transportimin e këtij narkotiku e bëjnë edhe përmes autobusëve nga agjenci të ndryshme të udhëtimit, me anë të kamionëve për bartjen e mallrave etj.

Substanca narkotike 'kanabis sativa', kultivohet nëpër lokacione të ndryshme në vendin tonë, zakonisht larg zonave të banuara, në vende të fshehura, nëpër oborre të shtëpive etj.

Policia me sukses ka identifikuar dhe ka zbuluar disa laboratorë të kultivimit të kësaj bime. Gjithashtu janë evidentuar edhe raste të mbirjeve të egra të bimëve të kanabisit, të cilat nuk janë kultivuar dhe nuk është përkujdesur askush për ato bimë.

Sipas të dhënave nga hetimi i rasteve por edhe të dhënave të inteligjencës, çmimi i mariuhanës në treg varion sipas kualitetit, vendit të destinacionit dhe mënyrës së transportimit të saj.

Përderisa një gram i substancës narkotike marihuanë, në tregun me pakicë kushton prej 5 deri në 7€, një kg. marihuanë në tregun me shumicë arrin çmimin 900-1300€, ndërsa çmimi i mariuhanës e cila kultivohet në ambiente të mbyllura varion nga 2300 € deri 2600 € për një kg.

Viteve të fundit është identifikuar një tendencë e përfshirjes së grupeve të organizuara kriminale të cilat në të njëjtën kohë merren me trafikimin e kokainës, por edhe mariuhanës, të cilat në Republikën e Kosovës, kryesisht hyjnë përmes Shqipërisë dhe kanë për destinim vendet e Evropës Perëndimore, me theks të veçantë në Austri, Gjermani, Zvicër, por në disa raste edhe Belgjikë.

E veçantë tjetër lidhur me trafikimin me mariuhanë është edhe tendenca në rritje e trafikimit të saj për në Turqi, kryesisht si formë e pagesës për heroinë, e cila në Kosovë trafikohet nga Turqia.

Marihuana e destinuar për përdorim të brendshëm, nuk është shumë vështirë të gjendet në shitje, andaj edhe përdorimi i saj nga moshat e reja, duke përfshirë edhe fëmijët është në trend shqetësues, duke përfshirë edhe përdorimin e saj edhe në ambiente të institucioneve edukativo - arsimore, si dhe në ndeja të ndryshme të organizuara nga të rinjtë.

Kokaina

Sipas drejtuesit të OJQ "Labyrinth", numri i përdoruesve të kokainës është gjithnjë në rritje dhe shqetëson fakti se të rinjtë edhe nën moshën 30 vjeç e deri tek të miturit, janë përdorues të kokainës.

Tregues i qartë i prezencës së kokainës në tregun kriminal në Republikën e Kosovës, është edhe ulja e çmimit të kokainës, që aktualisht sipas të dhënave nga hetimi i rasteve, si dhe të dhënave të inteligjencës, një gram i substancës narkotike kokainë, në tregun me pakicë kushton prej 35 deri në 50 €, një kg. kokainë në tregun me shumicë arrin çmimin 40.000-50.000 €.

Grupet kriminale që merren me trafikim të kokainës janë grupe shumë më të sofistikuara dhe janë më pak të ekspozuara në publik.

Gjatë vitit 2021, kanë qenë dy raste me konfiskim të sasisë së madhe të kokainës, ku në rastin e parë në Lipjan janë konfiskuar 400 kg. kokainë në një kontejner mallrash dhe në rastin e dytë, në pikën kufitare të Vërmicës, janë konfiskuar mbi 8 kg.



Zinxhiri i furnizimit me kokainë në Ballkanin Perëndimor e ka origjinën nga Amerika Latine, në portet e Adriatikut në Shqipëri dhe Mal të Zi (si Durrësi dhe Tivari). Këto porte janë përdorur për të importuar dërgesa të mëdha të kokainës, zakonisht të fshehura në dërgesat e frutave ose në lëkura të kafshëve nga Amerika Latine.

Tregu kosovar furnizohet me kokainë nga Shqipëria dhe Mali i Zi. Vendi ynë furnizohet me kokainë edhe përmes një rruge tjetër e cila e ka fillin nga Bullgaria, në Maqedoninë e Veriut dhe prej andej në Serbi dhe në pjesën veriperëndimore të Kosovës.

Në vendin tonë, një sasi e kokainës mbetet për përdorim të brendshëm, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet përmes shteteve të rajonit drejt tregjeve në Evropën Perëndimore⁵.

Sa i përket këtyre grupeve kriminale, roli i shtetasve kosovar në këto grupe zakonisht është si ndërmjetësues, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e financimit të blerjes së kokainës.

Furnizimi me sasi të vogla të kokainës për përdorim të brendshëm, bëhet kryesisht nga Republika e Shqipërisë, ku trafikantët furnizohen me sasi nga 200 gr. deri në 2 kg., të cilat i sjellin në Kosovë, zakonisht duke i fshehur në pjesë të trupit apo në ndonjë vend të posaçëm në automjete. Narkotikun e shpërndajnë me nëngrupe të vogla, të cilat më pas i furnizojnë përdoruesit që kryesisht janë persona me buxhet të mirë financiar.



Trafikantët e kokainës që bëjnë furnizimin me pakicë zakonisht janë grupe të ndryshme, nuk kanë ndonjë organizim strukturor ashtu si grupet e tjera të njohura në nivel ndërkombëtar.

Tregu i konsumit të kokainës është relativisht homogjen dhe ekzistenca e tregjeve më të vogla në kryeqytete duket se është një model i zakonshëm në rajon. Në kryeqytete, kokaina disponohet në sasi zakonisht më të vogla se grami tradicional.

Në Mal të Zi për shembull, gjysmë grami kokainë kushton 40 € - 45 €. Në Kosovë, oferta më e përhapur është 0,6 gram për rreth 55 € - 60 €. Opsione të ngjashme janë në dispozicion në Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinë. Në Shqipëri, është

⁵ Raport studimor i Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs) "Analizimi i fluksit të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor": https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/WB-Hotspots-3_AL-web.pdf

gjithashtu e mundur të gjesh kokainë “crack” (për të tymosur) me një kosto prej rreth 20 deri në 25 euro për 0,2 gramë⁶.

Viti	Konfiskimi i Kokainës në kg.
2016	0.168 kg.
2017	0.711 kg.
2018	1.5 kg.
2019	1.58 kg.
2020	2.66 kg.
2021	414.95 kg.

Konfiskimi i kokainës ndër vite i shprehur në kg.

Heroina

⁶Raport studimor i Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs) “Analizimi i fluksit të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor”: https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/WB-Hotspots-3_AL-web.pdf

Sa i përket heroinës, sipas statistikave policore, por edhe të dhënave nga institucionet e tjera, duke përfshirë edhe shoqërinë civile, vërehet një rënie e përdorimit të saj në vendin tonë, e cila në sasi të vogla hyn në Kosovë përmes Shqipërisë, si dhe përmes rrugës së vjetër të trafikimit Turqi - Bullgari - Maqedoni e Veriut - Kosovë, ku një sasi shitet për konsumuesit në Kosovë, ndërsa sasi më e madhe dërgohet në Evropë përmes Serbisë dhe Malit të Zi, me destinacion kryesisht Austrinë, Gjermaninë dhe Zvicrën. Çmimi i një kilogrami heroinë në Turqi është 7000 euro, kurse në Kosovë 15 000 euro⁷ ndërsa në vendet e Evropës Perëndimore mund të shkojë deri në 25 000 - 30 000 euro, që është një tregues i qartë i përfitimit nga grupet e organizuara kriminale të përfshira



në këtë aktivitet kriminal.

Grupet kriminale që merren me trafikim ndërkombëtar të heroinës janë grupe aktive të cilat operojnë në Kosovë. Edhe përkundër se disa nga këto grupe janë shkatërruar nga organet e sigurisë, heroina vazhdon të jetë një ndër drogat kryesore që trafikohet në nivel ndërkombëtar nga shtetasit kosovarë. Këto grupe kriminale, vend burimor të furnizimit e kanë Turqinë, prej nga furnizohen me heroinë, të cilën më pas përmes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut e sjellin në Kosovë.

⁷ Të dhëna nga Inteligjenca & Raport studimor i Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs) "Analizimi i fluksit të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor": https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/WB-Hotspots-3_AL-web.pdf

Transportimi i heroinës nga Turqia zakonisht bëhet përmes kamionëve transportues, të cilët bartin mallra legale si tekstil, pajisje ndriçimi, pllaka mermeri etj., por brenda tyre fshihet substanca narkotike.



Fshehja e heroinës në bateri të automjetit

Në Kosovë, në shumicën e rasteve, kjo sasi e narkotikëve përzihet me një sasi të prekursorëve, pastaj fshihet në pjesë speciale të modifikuara në veturë, autobus, kamionë e më pas përmes trafikantëve kosovarë, dërgohet në vendet perëndimore në sasi nga 1 kg. deri në 10. kg., apo edhe në raste të caktuara përmes kompanive të transportit të mallrave, nëse sasia e heroinës së trafikuar është më e madhe.

Përderisa në të kaluarën, roli i grupeve kriminale nga Kosova në trafikimin e heroinës ishte dukshëm më i ndryshëm, duke u bazuar në bashkëpunimin dhe tregtinë me grupet e vendeve tjera, aktualisht roli i grupeve kosovare është blerja e heroinës direkt në Turqi, të cilat përmes kompanive të specializuara për transportin dhe importin e mallrave nga Turqia e sjellin në Kosovë.

Kjo mënyrë e funksionimit, sigurisht që ka rritur edhe fitimin nga ana e grupeve të organizuara kriminale, të cilat dyshohet se një pjesë të mjeteve e pastrojnë brenda Kosovës, përmes të paluajtshme.

Kohëve të fundit është vërejtur dukuria e shkëmbimit të marihuanës me heroinë, ku trafikantët kosovarë, përmes bashkëpunësorëve në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë sigurojnë sasi të mëdha të marihuanës deri në një ton, të cilën e dërgojnë në Turqi dhe e shkëmbejnë me heroinë.

Në vendin tonë, heroina ka një rënie të dukshme në përdorim, numri i konsumuesve nuk vërehet se ka ndonjë ngritje dhe besohet se heroina është një nga shkaktarët e disa prej vdekjeve nga drogat.

Viti	Konfiskimi i heroinës në kg.
2016	0.084 kg.
2017	0.391 kg.
2018	119 kg.
2019	7.7 kg.
2020	8.9 kg.
2021	3.6 kg.

Konfiskimi i heroinës ndër vite, i shprehur në kilogram

Sipas të dhënave në tabelën e lartcekur, shihet qartë trendi më i ulët i rasteve të konfiskimit të heroinës që do të thotë se ky është edhe një tregues tjetër për rënie të ndjeshme të trafikimit të heroinës në Kosovë por edhe i transitit të saj drejt vendeve tjera.

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Krahasuar me periudhat e mëparshme vërehet se raportimi i rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë është në rënie të vazhdueshme dhe po ashtu ka ndryshuar edhe trendi i trafikimit në aspektin e origjinës së viktimave, ku numri i viktimave që vijnë nga shtetet e tjera është gjithnjë e më i vogël në krahasim me vitet e kaluara dhe trendet e këtij fenomeni kriminal janë duke shkuar në drejtim të organizmit të rrjeteve individuale të kriminalitetit në grupe të vogla, pa organizim të mirëfilltë, me një përqendrim më të madh në qytetet kryesore.

Faktorët që supozohet se kanë ndikuar në rënien e kësaj dukurie kriminale konsiderohen: Infrastruktura e mirë ligjore⁸, ngritja e nivelit profesional e të gjithë zyrtarëve që drejtpërdrejt trajtojnë rastet e trafikimit, aktivitetet parandaluese që bëjnë të gjitha institucionet dhe OJQ-të e ndryshme, veprimet proaktive të Policisë me shtimin e kontrolleve dhe aktiviteteteve të tjera në vendet ku mund të jenë apo të identifikohen viktimat potenciale të trafikimit si në lokale nate, sallone masazhi, fëmijët në situatë rruge, sensibilizimi i opinionit përmes ligjëratave, punëtorive, debateve, komunikatave për media dhe aktivitete të tjera me karakter vetëdijesues.

RASTET	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Trafikim me njerëz	70	40	19	25	20	27
Mundësim prostitucioni	24	27	42	36	11	40
Marrje me prostitucion	31	36	41	35	17	33
Shfrytëzim për robëri	0	0	0	1	0	0
Heqje e organeve	0	0	0	0	0	0
Të tjera...	146	130	138	34	14	31

Statistikat krahasuese sipas periudhave 2016-2018 dhe 2019-2021

Sipas të dhënave në tabelën e lartcekur, shihet qartë trendi më i ulët i rasteve të raportuara të trafikimit me njerëz në periudhën kohore 2020, që mund të ndërlidhen me masat kufizuese kundër përhapjes së pandemisë me virusin 'COVID 19'.

Përderisa në të kaluarën viktimat e trafikimit kryesisht janë shfrytëzuar përmes kërcënimeve, skllavërisë apo edhe premtimeve për ofrimin e vendeve të punës dhe pagesave të mira, kohëve të fundit janë identifikuar edhe forma të tjera të mbajtjes nën kontroll të viktimave të trafikimit, siç janë: përmes mashtrimit, joshjes, dhunës fizike dhe psikike e posaçërisht shantazhit, raste të cilat pothuajse nuk raportohen fare dhe është tejet e vështirë që të identifikohen.

⁸ Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit & Ligji për kompensimin e viktimave të krimit.

Trafikantët përdorin shpesh metodën e “djalit të dashuruar” për të joshur viktimat e sidomos viktimat e mitura. Ata gjithnjë e më shumë gjurmojnë dhe rekrutojnë të mitura përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të tjera të komunikimit ‘online’, duke i joshur viktimat për takime intime, të cilat shpeshherë incizohen me video dhe përdoren për mbajtjen nën kontroll përmes shantazhit të viktimave të trafikimit.

Trafikimi me njerëz zhvillohet në mënyrë të fshehur dhe shumica e viktimave në mënyrë sistematike detyrohen nga trafikantët në ushtrimin e prostitucionit me anë të kërcënimit, shantazhit, frikësimit dhe të mashtrimit, prandaj viktimat hezitojnë t’i raportojnë rastet në Polici, dhe as nuk kanë guxim të flasin për gjendjen në të cilën ndodhen edhe kur zbatuesit e ligjit janë në kontakt dhe bisedojnë me to, ato nuk e pranojnë një gjë të tillë.

Grupet kriminale të trafikimit me njerëz, i kanë avancuar dhe përsosur edhe më tej teknikat e tyre të identifikimit, rekrutimit dhe shfrytëzimit të viktimave të trafikimit deri në atë masë, sa që ka raste kur edhe vetë viktimat e trafikimit, sidomos të moshës së mitur, nuk janë të vetëdijshme se mund të jenë viktimat e trafikimit.

Referuar statistikave zyrtare forma kryesore e shfrytëzimit të viktimës së trafikimit është ajo e detyrimit në prostitucion, duke mos përfshirë rastet edhe të detyrimit për kërkim lëmshë dhe punë të detyruar.

Viktimat e trafikimit sipas formës së shfrytëzimit	2019	2020	2021
Shfrytëzim për prostitucion të tjerëve	18	07	19
Shfrytëzim për pornografi dhe forma tjera të shfrytëzimit seksual	01	00	0
Shfrytëzim për shërbime apo punë të detyruar	02	10	03
Shfrytëzim për lypësi/lëmshë	01	00	03
Shfrytëzim për mbajtje në skllavëri apo kushte të ngjashme	02	00	0
Martesë e detyruar	01	00	0
Shfrytëzim për robëri apo heqje të organeve	00	00	0
Shitje e fëmijës	01	00	0

Tabela statistikore për viktimat e trafikimit e ndarë sipas viteve 2019-2021 dhe sipas veprave penale

Gjatë periudhës kohore 2019 – 2021 janë identifikuar gjithsejtë 68 viktimat të trafikimit, ku 49 prej viktimave të trafikimit janë të grup moshës nën 18 vjeçare, si kategori më e rrezikuar, duke qenë shumë më e lehtë për trafikantët manipulimi dhe mbajtja nën

Viktimat e identifikuar sipas grup-moshave								
Grup mosha	nën 18	18-22	23-25	26-30	31-35	36-40	mbi 40	Totali
Viti 2019	15	04	01	03	02	01	00	26
Viti 2020	15	01	01	00	00	00	00	17
Viti 2021	19	05	00	00	00	00	01	25

Tabela me të dhëna lidhur me grupmoshat e viktimave të trafikimit periudha 2019-2021

kontroll e tyre.

Bazuar në moshën e viktimave të trafikimit, sidomos të atyre nën moshën 18 vjeçare, lind dyshimi që numri i viktimave të jetë shumë më i lartë, por që si pasojë e kërcënimeve, viktimat të mos marrin guximin të raportojnë rastet tek autoritetet.

Gjithashtu mbetet evidente tërheqja e viktimave nga dëshmia e tyre në gjykatë dhe kjo në disa raste mund të ndodh për shkak të kërcënimeve nga ana e trafikantëve ndaj viktimave të trafikimit, apo edhe familjes së tyre.

Megjithatë disa viktimat të trafikimit tërhiqen nga dëshmia edhe si rezultat i proceseve të gjata gjyqësore, që mund të përfshijë edhe ndryshimin e statusit civil të viktimës së trafikimit, të cilat pasi të krijojnë familje nuk iu përgjigjen ftesave të gjykatës.

Targetimi i viktimave nga trafikantët zakonisht përqendrohet te personat që janë lehtë të manipulueshëm, kryesisht që kanë probleme në familje, që kanë kushte të vështira ekonomike, që largohen herë pas here nga shtëpia, persona të paemancipuar me nivel shkollimi fillor ose të paarsimuar fare, femra të moshave të mitura, pastaj duke përdorur metoda mashtrimi, përmes premtimeve për martesë, premtimeve për

Niveli i arsimit të viktimave	2019	2020	2021
I lartë	0	0	0
I mesëm	6	10	0
Fillor	17	6	17
Analfabet	2	1	8

Tabela e cila tregon nivelin e arsimit të viktimave të trafikimit periudha 2019-2021

punësim, për studime etj.

Sa i përket vendit të origjinës së viktimave të trafikimit, në këto tri vitet e fundit 2019 – 2021 shumica e viktimave janë me prejardhje nga Kosova, ndërsa një numër shumë i ulët vijnë edhe nga Shqipëria dhe shtetet fqinjë. Kjo mund të jetë e ndërlidhur drejtpërsëdrejti me strukturën e grupeve kriminale të trafikimit me njerëz në Kosovë, pasi që shënjestrimi i viktimave kosovare kërkon më pak burime financiare, sidomos në aspektin e strehimit dhe angazhimit të burimeve njerëzore për mbikëqyrjen e tyre. Gjithsesi, kjo ndërlidhet edhe me mënyrën e kryerjes, pasi që iu vështirëson punën e hetuesve në identifikimin e viktimave të trafikimit, duke pasur parasysh që tashmë nuk gjenden lokale, motele apo edhe biznese tjera statike, ku mbahen viktimat e trafikimit.

Aktualisht nuk ka të dhëna në dispozicion mbi mundësinë e ekzistimit të grupeve apo rrjeteve të grupeve ndërkombëtare të trafikimit, të cilët mund të përdorin Republikën e Kosovës, si vend tranzit apo edhe burim të trafikimit me njerëz.

Gjithashtu aktualisht nuk ka të dhëna mbi identifikimin e viktimave të trafikimit me origjinë nga Kosova në vendet tjera, andaj edhe për momentin nuk mund të vërtetohet mundësia e rekrutimit të viktimave kosovare me qëllim të shfrytëzimit të tyre në vendet tjera.

Viktimat e identifikuara në bazë të origjinës	2019	2020	2021
Kosovë	21	17	24
Shqipëri	1	0	01
Serbi	2	0	0
Mali i Zi	2	0	0
Totali	26	17	25

Tabela e cila tregon viktimat e identifikuara në bazë të origjinës periudha 2019-2021

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Qenie Njerëzore, përmes zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar ILECU ka komunikuar me SIENA/Europol, në kuadër të aksionit “Ditët e veprimit të përbashkët/Joint Action Day”, në rastin e trafikimit me njerëz dhe ka arritur rezultate në këtë drejtim.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve është një dukuri që ka ekzistuar edhe përpara se njerëzit të fillojnë të komunikojnë përmes internetit. Tash me ndryshimin e formave të komunikimit, rreziku i shfrytëzimit për qëllime seksuale ose abuzimi me fëmijët, është bërë një dukuri me përmasa shumë më të gjëra sesa më parë, me tipare dhe mënyra të reja të shfaqjes. Keqbërësit përdorin metoda dhe mjete mjaft të sofistikuara për të kryer këtë aktivitet dhe për këtë arsye hetimi i këtyre veprave nuk është i lehtë. Krimi seksual përmes internetit shpeshherë kryhet nga kriminelë që veprojnë si individ.

Sipas një kërkimi të huaj shkencor ka dalë përfundimi se një ndër katër fëmijë shfrytëzohen seksualisht në internet. Ky kërkim ka provuar se edhe kur fëmijët-viktima të abuzimit seksual nuk rrëfejnë se çfarë kanë pësuar, kjo nuk do të thotë aspak se dukuria nuk ka ndodhur⁹.

Abuzimi seksual me fëmijë bëhet në forma dhe metoda të ndryshme, duke përfshirë shfrytëzimin e fëmijëve për prostitucion, shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet, ofrimin e materialit pornografik, trafikimin e fëmijëve për qëllime seksuale, shfrytëzimin seksual të fëmijëve në kontekstin e udhëtimeve dhe turizmit, premtimin e rrejshëm për martesë duke nxitur aktin seksual, disa forma të martesave në moshën e fëmijërisë, në moshë shumë të re, apo martesave me detyrim.

Në periudhën kohore 2019-2021, duke u bazuar në statistikat policore¹⁰, vërehet se janë raportuar 302 vepra penale që kanë të bëjnë me shfrytëzimin seksual të fëmijëve në Republikën e Kosovës, ku viti i fundit shënon rritje të rasteve, me gjithsej 122.

Veprat penale më të theksuara të shfrytëzimit seksual të fëmijëve janë dhunimet dhe sulmet seksuale. Shqetëson fakti se ka rritje të trendit të dhunimeve përgjatë tri viteve raportuese, ku gjithsej kanë ndodhur 147 raste të dhunimeve, prej tyre 6 raste kanë mbetur në tentativë. Janë evidentuar raste ku persona të dyshuar kanë shkarkuar, shikuar dhe shpërndarë përmes internetit materiale (foto dhe video) ku janë të përfshirë fëmijët duke u abuzuar seksualisht. (Shih tabelën e mëposhtme për llojin e krimeve seksuale dhe statistikat):

⁹ Hulumtimi shkencor "Policing Social Networking Sites and Online Grooming"-John Taylor:<https://www.medialook.al/shfrytezimi-dhe-krimi-seksual-mbi-femijet-ne-web/><https://www.medialook.al/shfrytezimi-dhe-krimi-seksual-mbi-femijet-ne-web/>

¹⁰ Njësia Qendrore e Sistemit Informativ të PK-së/SIPK

Rastet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve 2019-2021	Viti		
	2019	2020	2021
Dhunimet	34	38	75
Sulmet seksuale	35	27	33
Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit	4	1	5
Degradimi i integritetit seksual	2	2	0
Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjeç	0	0	1
Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi	1	1	2
Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejtshëm të martesës	3	1	4
Mundësimi ose detyrimi në prostitucion	3	0	2
Ofrimi i lokaleve për prostitucion	0	1	0
Nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (kodi penal 2012)	2	0	0
Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale (Kodi penal 2012)	2	0	0
Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç (kodi penal 2012)	23	0	0
Totali	109	71	122

Tabela lidhur me rastet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në periudhën 2019-2021

Lidhur me këto raste janë evidentuar 295 viktima të mundshme të moshave të ndryshme nën 18 vjeç. Viktimat më të prekura me rastet e shfrytëzimit seksual i takojnë moshës së mitur prej 14-18 vjeç, ku dominojnë fëmijët e gjinisë femërore të moshës 15 - 16 vjeçe.

Statistikat zyrtare lidhur me shfrytëzimet seksuale të fëmijëve nuk paraqesin gjendjen reale në këtë fushë, ndonëse viteve të fundit ka më shumë raste të hapura sesa më herët.

Moshë dhe gjinia e viktimave të shfrytëzimit seksual		
Moshë	Femra	Meshkuj
5 vjeç	1	0
8 vjeç	0	1
9 vjeç	1	1
10 vjeç	1	0
11 vjeç	9	0
12 vjeç	13	7
13 vjeç	27	0
14 vjeç	48	0
15 vjeç	61	3
16 vjeç	55	10
17 vjeç	42	1
18 vjeç	14	0
Totali	272	23

Moshë dhe gjinia e viktimave të shfrytëzimit seksual

Krimi seksual është një fenomen më i përhapur sesa që mendohet në përgjithësi.

Ekziston perceptimi se në praktikë ka raste që nuk raportohen në organet kompetente, as nga vetë fëmijët e abuzuar, por as nga shokët e tyre dhe shpesh as prindërit e tyre nuk janë të gatshëm të raportojnë duke u frikësuar se pas raportimit, fëmija dhe familja e tij do të bëhen objekt i fjalëve të komunitetit dhe mediave. Prandaj shumë viktima mbeten të pafidentifikuara dhe abuzuesit e tyre të pazbuluar për shkak të këtyre rrethanave.

Edhe nëse ndodh raportimi i rastit, prindërit hezitojnë, për të njëjtat arsye, për të kërkuar ndihmë në institucionet për përkrahje psikologjike, për trajtimin e fëmijëve të tyre të cilët kanë qenë viktima në këto raste.

Fëmijët, të cilët në një moshë të re kanë qenë viktima të shfrytëzimit seksual, nëse nuk trajtohen me kohë nga ky dëm psikologjik dhe fizik në institucionet përkatëse, ata mund të përjetojnë probleme serioze në shëndetin mendor dhe në zhvillimin normal të jetës së tyre.

Ndër format më shqetësuese të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, përkatësisht të personave nën moshën 18 vjeçare është trafikimi me qenie njerëzore, që sipas të dhënave të viktimave të trafikimit, është shqetësuese numri i lartë i viktimave të trafikimit nën moshën 18 vjeçare.

Viti	Viktimat e trafikimit nën moshën 18 vjeçare
2019	15
2020	15
2021	19

Tabela statistikore për viktimat e trafikimit nën moshën 18 vjeçare

Për shkak të faktorëve të ndryshëm socio-ekonomik, vendi ynë përballlet me një numër të martesave – bashkëjetesave të miturve mes moshës 16 dhe 18 vjeç.

Kosova ka një bazë të mirë ligjore në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve duke përfshirë Kushtetutën e Kosovës, Kodin penal, Kodi i drejtësisë për të mitur, Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje, Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave, të cilat janë në pajtueshmëri me standardet evropiane. Po ashtu, janë ratifikuar konventat ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

KONTRABANDIMI ME MIGRANTË

Çdo vit, numër i madh i njerëzve migrojnë nga vendet e tyre për në vendet tjera në kërkim të një jetese më të mirë, shpeshherë për ta realizuar këtë migrim nevojitet edhe ndërhyrja e kontrabandistëve, veprimet e të cilëve përbëjnë një element kërcënues për sigurinë dhe stabilitetin e vendeve dhe shoqërive të cilat atakohen.

Përderisa para disa viteve, posaçërisht gjatë viteve 2014 dhe 2015 ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohej Republika e Kosovës në aspektin e kontrabandimit me migrantë, ishte migrimi i paligjshëm i kosovarëve në drejtim të vendeve të BE-së, trendi aktual i kontrabandimit të migrantëve dhe migrimit të paligjshëm të shtetasve të huaj, kryesisht nga vendet e Lindjes së Mesme, siç janë, Siria, Iraku, Maroku, Afganistani, Pakistani, Palestina, Jemeni etj. të cilët e përdorin territorin e Republikës së Kosovës si vend transit me synimin të arrijnë në destinacionin e tyre final, e që janë vendet e BE-së.

Krizat e vazhdueshme gjithnjë në rritje në këto vende, luftërat e ashpra, përfshirë këtu luftërat civile, varfëria, papunësia dhe paqëndrueshmëria politike, problemet religjioze, pasiguria dhe pabarazia qytetare, pa siguria sociale etj., janë duke prodhuar migrim ilegal të vazhdueshëm nga këto vende drejt Bashkimit Evropian, duke krijuar një bazë të madhe për më shumë migrantë si dhe rritje të kontrabandës së tyre.

Duke marrë parasysh numrin e madh të migrantëve nga shtetet e lartpërmendura të cilat janë në lëvizje nga shtetet ku janë të strehuar në Turqi dhe Greqi drejt vendeve të BE-së, për të përfituar nga këto rrethana, me qëllim të përfitimit material, janë krijuar grupe kosovare të kontrabandimit me migrantë si dhe grupe nga të gjitha vendet fqinje nëpër të cilat kalojnë migrantët deri në vendet e destinacionit që janë vendet e BE-së.


Grupet kosovare të kontrabandimit me migrantë si dhe grupet nga disa vende fqinje merren me kalimin e kufirit ilegalisht të migrantëve, strehimin e tyre dhe transportimin nga një skaj i kufirit në skajin tjetër. Këto grupe në të shumtën e rasteve nuk mund t'ju ofrojnë shërbime të plota migrantëve të huaj edhe nëpër shtetet tjera, prandaj bashkëpunojnë edhe me grupe tjera nga vendet nëpër të cilat duhet të kalojnë migrantët.

Profilet e grupeve kriminale nga Kosova të përfshira në kontrabandim me migrantë, janë të ndryshme, duke filluar nga grupe të vogla e deri te ato me strukturë, bashkëpunojnë me grupe tjera kriminale në nivel vendi dhe më gjerë, varësisht prej strukturës së grupit, si dhe grupe të përziera të nacionaliteteve: shqiptarë, turq, serb etj.

Në Republikën e Kosovës, nga ana e Policisë kohë pas kohe janë ndaluar emigrantë të huaj të cilët kanë qenë duke hyrë ose pasi kanë hyrë në Republikën e Kosovës ilegalisht.

Ata, kryesisht kanë qenë nga shtetet e lindjes së mesme të cilët gjatë intervistimit kanë kërkuar që të lejohen të shkojnë në shtetet e Bashkimit Evropian pasi që këto shtete janë edhe destinacioni i tyre.

Numri i migrantëve të huaj të regjistruar në Kosovë



Diagrami i cili pasqyron numrin e migrantëve të huaj të regjistruar në Kosovë nëpër vite

Edhe pse Kosova ju ka ofruar kushte të mira emigrantëve të huaj, një gjë është e ditur se emigrantët e huaj, Kosovën po e shfrytëzojnë vetëm si vend transit, sikurse që po i shfrytëzojnë edhe vendet e tjera të Ballkanit dhe se synimi i tyre është që ata të shkojnë në vendet e Bashkimit Evropian. Shuma e parave që përfitojnë kontrabandistët nga migrantët është 200 deri 300 euro për kalimin e një shteti, ndërsa rreth 1.800 deri 3.500 euro deri në shtetin evropian ku është destinacioni i tyre¹¹.

¹¹ Të dhëna nga Inteligjenca



Foto Ilustrim, Kontrabandimi me migrant

Para disa viteve ka pasur raste kur migrantët e huaj janë hasur në Kosovë të ngarkuar në rimorkio të kamionëve transportues të fshehur në mallra, mirëpo viteve të fundit që nga mbyllja e vijës së gjelbër e kufirit me Turqinë nga ana e Greqisë kontrabandimi i migrantëve të huaj është duke u zhvilluar në forma tjera, nëpër disa faza, dhe nga më shumë grupe kontrabandistësh, varësisht nga vendet nëpër të cilat kalojnë migrantët.

Gjatë qëndrimit të migrantëve të huaj në vendin tonë ka raste ku disa prej tyre kanë qenë të involvuar në kundërvajtje dhe vepra penale.

Policia e Kosovës në vazhdimësi i ka kushtuar rëndësi luftimit të kontrabandimit me migrantë duke zhvilluar kontrolle, hetime, patrullime, duke realizuar plane taktike - operative të cilat disa herë kanë rezultuar të suksesshme në identifikimin dhe kapjen e të dyshuarve për kontrabandim me migrantë.

Viti	2019	2020	2021
Numri i rasteve	5	1	2
Personat e arrestuar (dyshuar)	9	3	10
Grupe kriminale të shkatërruara	1	1	2
Kallëzime penale	4	1	1
Plane operative	3	1	1
Kontrolle	9	3	12
Bashkëpunim ndërkombëtar	/	1	2

Tabela statistikore për periudhën 2019-2021, Kontrabandim me migrantë

Kosova përballlet me dy kategori të kontrabandimit të migrantëve:

- Kontrabanduesit e migrantëve kosovarë të cilët migrojnë në vendet e BE-së dhe
- Kontrabanduesit e migrantëve të huaj të cilët migrojnë në vendet e BE-së duke kaluar transit nëpër vendin tonë.

Kontrabandimi me migrantë kosovarë

Edhe migrimi i një numri të qytetarëve kosovarë drejt vendeve më të zhvilluara bëhet në kërkim të kushteve më të mira të jetesës, për kushte më të mira në shkollim, punësim, kualiteti i lartë shëndetësor, sigurime shëndetësore, sistem i mirëfilltë i drejtësisë, fonde pensionale etj. dhe në përgjithësi, migrimi, qoftë i parregullt apo i rregullt, mbetet një element i rëndësishëm dhe mjaft sfidues për institucionet e Kosovës dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kosova është i vetmi vend në rajon që është jashtë zonës së schengenit të udhëtimit të lirë, prandaj kontrabandimi i migrantëve kosovarë drejt vendeve të BE-së, me qëllim migrimi është duke ndodhur ende, por me numër shumë më të ulët sesa në periudhat e kaluara.

Nga fillimi i vitit 2016 e këndej, trendet e migrimit të kosovarëve kanë lëvizur drejt zvogëlimit të emigrimit të parregullt/ilegal dhe rritjen e migrimit të rregullt/legal. Faktorët të cilët kanë ndikuar në zvogëlimin e migrimit të parregullt përfshijnë ndryshimet në politikat e azilit në shtetet anëtare të BE-së, në radhë të parë duke i shkurtuar arsyet e azilit si dhe duke i vendosur vendet e Ballkanit Perëndimor në listën e vendeve të sigurta të origjinës.

Pas këtij ndryshimi në politikat e azilit në BE ka pasur një rënie të madhe të numrit të qytetarëve të kontrabanduar nga Kosova për në vendet e Evropës Perëndimore për shkak se pjesa më e madhe e migrantëve kosovarë, të cilët kanë shkuar në vendet e BE-së e që nuk kanë pasur leje qëndrimi edhe ata që kanë kërkuar azil janë kthyer mbrapsht në Kosovë.

Në zvogëlimin e numrit të kontrabandimit të migrantëve kosovarë drejt BE-së gjatë kësaj periudhe ka ndikuar edhe pandemia Covid-19 gjatë 2020 dhe 2021 e cila imponoi shumë kufizime të lëvizjes së qytetarëve në mes të shteteve por edhe brendapërbrenda shteteve, pastaj kriza ekonomike që përfshiu shumë shtete si pasojë e kësaj pandemie për shkak të mbylljes së shumë vendeve të punës për një periudhë kohore etj.

Por edhe përkundër kësaj, një numër i madh i qytetarëve kosovarë ende vazhdon të ketë për synim migrimin në ndonjërin nga vendet e BE-së dhe këto rrethana janë duke i shfrytëzuar grupet kriminale të kontrabandimit me migrantë, të cilat janë duke e mundësuar kontrabandimin e migrantëve edhe pse jo në përmasa sikur në të kaluarën.

Disa nga metodat të cilat kontrabanduesit janë duke i përdorur gjatë kontrabandimit të migrantëve nga Kosova janë:

- me pasaporta false të shteteve të ndryshme të BE-së,
- me pasaporta origjinale të personave shtetas të BE-së duke u bazuar në ngjashmëritë fizike dhe të dhënave në mes personit në pasaportë dhe migrantit,
- me pasaporta të Serbisë,
- leje qëndrimi të vendeve të BE-së,
- kalimi i kufijve ilegalisht etj.

Kontrabandimi me migrantët e huaj

Migrantët e huaj nga vende të treta kontrabandohen deri në kufi me Kosovën nga grupe kriminale nga shtetet fqinje Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Nga zonat kufitare me këto shtete, grupe të përbashkëta kontrabandistësh nga Kosova dhe shtetet përkatëse, në shumicën e rasteve në këmbë dhe nëpër male i sjellin migrantët deri në Kosovë, ku i strehojnë kryesisht nëpër shtëpi të pabanueshme dhe pastaj në kohën më të përshtatshme i dërgojnë tutje në drejtim të pjesës së veriut të Kosovës për në Serbi.

Një pjesë tjetër të migrantëve kontrabanduesit i lënë në brendi të Kosovës derisa ata të bëjnë zgjidhje të përkohshme të cilët fillimisht lajmërohen si azilantë dhe strehohen në qendrat e azilit, ndodh që për një kohë shumë të shkurtër, brenda dy deri në dhjetë ditë, azilkërkuarit e lëshojnë qendrën për azil, ku janë të vendosur dhe nga kontrabanduesit transportohen kryesisht deri në Serbi.

Në vendin tonë, janë vërejtur dy lloj kategori të migrantëve të huaj, kategoria e parë migrantët e pasur të cilët nga ana e kontrabanduesve janë akomoduar nëpër banesa private si dhe hotele të marra me qira dhe pastaj janë përcjellë deri në Serbi dhe kategoria e dytë e migrantëve të varfër të cilët strehohen në vendbanime në ndonjë

shtëpi të vjetër të pa banueshme deri sa të krijohen kushtet për t'i kontrabanduar në Serbi.

Sipas informatave si dhe deklaratave të migrantëve, ata vijnë në Kosovë ilegalisht, nga qendrat e azilit në Greqi dhe Turqi, përmes shteteve të rajonit, duke përfshirë Shqipërinë, Serbinë, Maqedoninë e Veriut. Është evidentuar njëra ndër linjat e kontrabandimit të tyre, e cila fillon në Greqi, pastaj vazhdohet për në Shqipëri - Kosovë - Serbi - Hungari.

Kontrabanda me migrantë nga vendet e treta, përmes Kosovës në drejtim të vendeve të Bashkimit Evropian, realizohet duke përdorur rrugë të ndryshme nga kontrabandistët. Për të hyrë në Serbi nga Kosova, kontrabandistët kanë shfrytëzuar disa nga këto rrugë/lokacione ilegale nga zonat kufitare të Bërnjakut dhe Jarinjës si dhe nga zonat përreth: Merdare, Dheu i Bardhë, Muqibabë, Karaçevë e ulët etj.

Gjatë periudhës 2019 - 2021, nga numri i përgjithshëm i azilkërkuesve në Republikën e Kosovës (sipas tabelës së mëposhtme), mbi 90% e tyre kanë hyrë në Republikën e Kosovës nga Shqipëria.

Pra, kufiri me Shqipërinë është më së shumti i atakuar nga kjo dukuri dhe kuptohet se edhe kontrabandimi me migrantë në hyrje në Kosovë është më i madhi në kufirin me Shqipërinë.

Më poshtë është paraqitur shtetësia e migrantëve të cilët kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare - azil, në Republikën e Kosovës në periudhën 2019-2021:

Shtetësia e migrantëve	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Siri	908	1330	708
Irak	560	197	36
Marok	151	310	214
Palestinë	93	229	32
Algjeri	119	107	83
Libi	52	139	59
Afganistan	52	77	81
Bangladesh	4	13	114
Turqi	53	29	21
Jemen	24	21	5
Tunizi	8	27	15
Egjipt	7	25	14
Iran	9	32	4
Liban	11	12	2
Pakistan	11	7	7
Somali	4	13	5
Jordani	0	8	1
Indi	1	0	5
Serbi	1	1	2

Sudan	1	2	1
Afrika e Jugut	0	3	0
Kongo	2	0	1
Kuvajt	0	0	3
Togo	0	0	3
Turkmentstan	3	0	0
Maqedoni e Veriut	0	0	2
Nigeri	0	2	0
Ukrainë	2	0	0
Bahama	0	0	1
Bosnja dhe Hercegovina	0	0	1
Çad	0	1	0
Kamerun	0	1	0
Kina	0	1	0
Malavi	1	0	0
Mali i Zi	1	0	0
Meksikë	0	1	0
Myanmar	0	0	1
Shqipëri	1	0	0
Venezuela	0	0	1
Total	2079	2588	1422

Procedurat e aplikimit për azil në Kosovë janë të përshtatura sipas standardeve të shteteve që janë pjesë e Bashkimit Evropian dhe këto procedura njëjtë si Kosova, edhe ato shtete i kanë të rregulluara me ligj.

Kërkesa për azil nga të huajt mund të bëhet me gojë apo në formën e shkruar gjatë kontrollit në pikën e kalimit kufitar, në çdo stacion policor por edhe direkt në zyrat e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM). Për personat që parashtrajnë kërkesën për azil dhe nuk kanë strehim, Kosova ofron akomodim kolektiv në Qendra për Azil.

Lidhur me migrantët e huaj, institucionet përgjegjëse të Kosovës kanë hasur në problem të identifikimit të saktë të migrantëve për shkak se një numër i madh i tyre nuk ka fare dokumente identifikuese ose edhe mund të kenë dokumente të falsifikuara dhe verifikimi i tyre është gati i pamundur për shkak të problemeve me marrëveshjet ndërkombëtare, sidomos me vendet prej nga vijnë shumica e tyre siç janë Algjeria, Maroku, Palestina dhe Siria, me të cilat Kosova nuk ka bashkëpunim as për të shkëmbyer informacione rreth identitetit, por edhe nëse kërkohet ndonjë ekstradim apo deportim i tyre, atëherë edhe në këtë drejtim për shkak të këtij mosbashkëpunimi është vështirë të vepohet.

Bazuar në zhvillimet në lindjen e mesme dhe Afrikën veriore, pritet që edhe në të ardhmen të ballafaqohemi me kontrabandimin me migrantë të huaj.

KRIMET KIBERNETIKE

Në nivel global por edhe në vendin tonë, kërcënimet nga krimet kibernetike konsiderohen ndër sfidat më të mëdha të sigurisë dhe privatësisë. Në bazë të raporteve ndërkombëtare, Kosova është e para në rajon, sa i përket përdorimit të internetit, me 1,72 milion përdorues të internetit ose 97 për qind të popullsisë së përgjithshme¹².

Për shkak të kufizimeve të ndryshme gjatë pandemisë COVID-19, shumë institucione dhe biznese në Kosovë, kanë kaluar në ofrimin e shërbimeve 'online' dhe kjo mund të ndikojë në shtimin e rasteve të krimeve kompjuterike.



Vështirësi në hetime krijon fakti se informacioni në internet, shumë shpejt mund të zhduket, posaçërisht, kur ky informacion gjendet jashtë vendit tonë.

¹² Raporti i titulluar "DIGITAL 2022", të publikuar nga Datareportal

Përveç kësaj, hetimi varet shumë edhe nga pajisjet dhe programet kompjuterike të nevojshme për gjurmim, identifikim, ruajtje të provave elektronike etj.

Nëse i krahasojmë tri vitet e fundit (2019, 2020 dhe 2021) me tri vitet paraprake (2016, 2017 dhe 2018) gjejmë se ka rritje të numrit të rasteve të krimeve kibernetike dhe njëkohësisht edhe rritje të efikasitetit të luftimit të krimeve kibernetike.

Rastet e krimeve kibernetike	2016-2018	2019-2021
Rastet e hetuara	125	134
Asistim në raste të nivelit rajonal dhe lokal	561	731
Kallëzime penale	62	74
Persona të dyshuar	85	180
Persona të arrestuar	43	73
Grupe kriminale të shkatërruara	2	6

Tabela statistikore për rastet e krimeve kibernetike nëpër vite

Krimet kibernetike më të shpeshta në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore janë:

- ❖ Hyrje në sistem kompjuterik;
- ❖ Keqpërdorim i kartelave bankare apo të kreditit;
- ❖ Keqpërdorim i fëmijëve në pornografi;
- ❖ Kanosje;
- ❖ Ngacmim;
- ❖ Mashtrim;
- ❖ Vjedhje e identitetit dhe pajisjes së qasjes;
- ❖ Prezantim i rremë si person zyrtar.

Rastet raportohen çdo herë në stacionet policore, por ndodh që për shkak të natyrës dhe peshës rastet raportohen drejtpërdrejt në nivelin qendror. Përcaktimi i saktë se a është kryer një krim kibernetik nga brenda apo jashtë vendit nuk është i lehtë, kjo për faktin e mundësive që ofron interneti dhe aplikacionet e ndryshme kompjuterike.

Ajo çfarë mund të thuhet sa i përket luftimit të krimeve kibernetike, është evidente se rastet që bien në fushën e krimeve kibernetike janë në rritje, gjithashtu edhe numri i rasteve të kanosjeve, mashtrimeve, shantazheve, keqpërdorimi i të dhënave personale që mundësohen të kryhen përmes kompjuterit apo internetit është në rritje.

Hetimi i një rasti tipik të krimit kibernetik është mjaft kompleks, kjo për arsye se një pjesë e hetimit varet nga institucione tjera të cilat janë mbajtës të të dhënave relevante, këto institucione janë vendore por në shumë raste ka edhe institucione ndërkombëtare. Marrë parasysh se informacioni i gjeneruar në internet shumë shpejt edhe mund të humb, e vështirëson hetimin posaçërisht kur ky informacion gjendet jashtë vendit tonë.

Përveç kësaj, hetimi varet shumë edhe nga pajisjet dhe programet kompjuterike të nevojshme për gjurmim, identifikim, ruajtjen e provave elektronike etj.

Spektori për Hetime të Krimeve Kibernetike ka luajtur një rol kyç në parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik duke bashkëpunuar ngushtë me institucione vendore dhe partnerë ndërkombëtarë.

Format dhe metodat e krimeve kibernetike

Gjatë hetimit të rasteve, janë identifikuar forma dhe metoda të ndryshme, përmes të cilave janë kryer vepra penale përmes internetit dhe sistemeve kompjuterike.

- Sulmet DDoS apo pengimi i funksionimit normal dhe ofrimit të shërbimeve në internet. Këto sulme janë bërë kundër ueb-faqeve të institucioneve të ndryshme publike dhe kompanive të biznesit.
- Ndërhyrja në ueb-faqe dhe ndryshimi i përmbajtjes duke vendosur mesazhe me përmbajtje të ndryshme.
- Bllokimi (kriptimi) i të dhënave kompjuterike përmes metodës RANSOMWARE. Çak janë kryesisht bizneset, duke mos anashkaluar individët por edhe institucionet e ndryshme.
- Phishing apo mashtrimi me të dhëna. Krijimi i ueb-faqeve të rrejshme dhe linçeve mashtruese me qëllim vjedhjen e të dhënave. Si mjet mashtrimi janë përdorur "lojërat shpërblyese".
- Mashtrimi përmes falsifikimit të emailave. Çak kryesor janë kompanitë e biznesit në Kosovë që bashkëpunojnë me kompanitë e biznesit në shtete të ndryshme. Keqbërësit, përmes veprimeve të ndryshme, arrijnë të kenë qasje në transaksionet financiare të bizneseve dhe në këtë mënyrë bëjnë modifikimin e faturave dhe ndryshimin e xhirollogarive bankare.
- Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi. Persona të dyshuar prodhojnë, shkarkojnë, posedojnë, shikojnë dhe shpërndajnë përmes internetit, materiale (video dhe foto) ku janë të përfshirë fëmijë, duke u abuzuar seksualisht.
- Vjedhja e të dhënave personale bankare, përmes mashtrimeve me email por edhe me thirrje telefonike. Viktimave u dërgohen emaila mashtrues kinse ata janë fitues të ndonjë loje shpërblyese apo lotarie.
- Blerjet 'online' dhe blerja nëpër markete e gjësendeve të ndryshme, përmes pajisjeve POS me kartela të klonuara, më pas shitja e këtyre gjësendeve tek personat e tjerë.
- Mashtrimet në internet përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme, shitjeve të produkteve të ndryshme etj. Janë regjistruar raste kur janë shitur bileta përmes internetit për udhëtim me aeroplan nga Gjermania për në Kosovë dhe pasi që është bërë pagesa, komunikimi është ndërprerë, por biletën nuk e ka pranuar blerësi.

- Vjedhje e identitetit, kryesisht hapja e llogarive të rrejshme dhe abuzimi me emra dhe foto të personave të ndryshëm dhe tentimi për të mashtruar të tjerët.
- Kanosje, promovim i veprimeve ekstremiste, ngacmime si dhe shantazhe përmes emailave dhe rrjeteve sociale (përfshirë edhe ndaj personaliteteve të rëndësishme publike dhe institucioneve).
- Cenim i të drejtave të autorit, publikime në internet të punës së tjetrit pa autorizim etj.

Duke u bazuar në rastet që janë hetuar në vendin tonë, janë identifikuar si fenomene disa forma që nuk janë krime kibernetike tipike, por që veprat penale mundësohen të kryhen përmes internetit dhe sistemeve kompjuterike.

- “Qendrat e thirrjes” - Të dyshuarit, fillimisht, sigurojnë të dhëna personale të të dëmtuarve (emra dhe mbiemra, numra telefoni, e-mail adresa etj.) përmes rrugëve të ndryshme, pastaj i thërrasin shtetasit e huaj përmes telefonit, duke iu bërë ofertë dhe duke i joshur për investime, nga të cilat do të kenë përfitime materiale.
- Blerjet ‘online’ me kartela bankare të vjedhura - të dyshuarit, përdorin kartela bankare të vjedhura nga shtetas të huaj, për të porositur dhe për të blerë mallra të ndryshme përmes internetit, brenda dhe jashtë vendit. Kartelat vidhen përmes formave të ndryshme dhe shiten pastaj nëpër forume të mbyllura.
- Mashtrimet në ueb-faqe dhe rrjete sociale - Të dyshuarit kanë shfrytëzuar situatën e pandemisë COVID-19, për të krijuar dhe për të shpërndarë lajme të ndryshme të rreme, që nuk vijnë nga persona dhe institucione të besueshme.
- Mashtrimi me të dhëna ose phishing - Të dyshuarit, duke shfrytëzuar viruset kompjuterike, krijojnë linqe të ndryshme dhe i dërgojnë tek viktimat, të cilët posa klikojnë në link, atyre iu kërkohet që të japin të dhënat personale, të rrjeteve sociale, të dhënat e e-mail adresës etj. Këto të dhëna, më pas i keqpërdorin për qëllime të ndryshme si: shantazh, ngacmim, vjedhje e identitetit dhe shfrytëzimi për publikim të lajmeve të rrejshme etj.
- Materialet (video dhe foto) me përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve - Janë evidentuar raste ku persona të dyshuar kanë shkarkuar, shikuar dhe shpërndarë përmes internetit materiale (video dhe foto) ku janë të përfshirë fëmijë duke u abuzuar seksualisht. Vërehet se moshat e reja janë mjaft të përfshirë në shpërndarjen e materialeve të tilla dhe për këtë i përdorin rrjetet e ndryshme sociale.

Në vendin tonë, ndonëse ende nuk ka ndonjë ligj që e rregullon çështjen e kriptovalutave, trendi i investimit dhe prodhimit të kriptovalutave, është në rritje. Policia e Kosovës ka hetuar raste të krimit kibernetik, ku të dyshuarit kanë vjedhur kriptovaluta nga kripto-kuletat e ankuesve dhe i kanë transferuar në kriptokuletat tjera të dyshuara.



Në dhjetor 2021 është formuar grupi punues për valutat virtuale ku pjesë e tij janë NjIF-K, ATK, Dogana, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës (Policia përfaqësohet nga DHKEK dhe SHKK-DHKO).

Edhe në vendin tonë, si në shumë vende të botës, operojnë një numër i bankomatëve për kripto-valuta, në këto bankomate kryhen shërbime të blerjes dhe shitjes së kriptovalutave.

Spektori për Hetime të Krimeve Kibernetike - DHKO ka trajtuar disa raste kur kriptovalutat iu janë marrë ankuesve nga kripto-kuletat e tyre dhe janë transferuar në mënyrë të paautorizuar në kripto-kuleta tjera të dyshuara.

Institucione të ndryshme kosovare kanë qenë cak i sulmeve kibernetike të cilat kanë sulmuar edhe infrastrukturën e sistemeve kompjuterike të institucioneve të ndryshme të vendit tonë, sidomos institucionet qeveritare. Gjatë hetimit të këtyre rasteve, janë

gjetur informacione se sulmi ka mundur të kryhet nga disa shtete me të cilat nuk kemi marrëdhënie diplomatike.

KORRUPSIONI

Prezenca e korrupsionit dhe shtrirja e gjerë e tij në institucionet publike është duke e dëmtuar procesin e shtet-ndërtimit, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin demokratik.

Po ashtu niveli i korrupsionit është duke e ngadalësuar edhe procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.



Korrupsioni ndikon në keqpërdorim të parave të tatimpaguesve, por edhe në shërbime jocilësore, trajtim të pabarabartë të qytetarëve e bizneseve, pasurim të paligjshëm të zyrtarëve publik dhe përkeqësim të mirëqenies së qytetarëve. Nga analiza e rasteve të raportuara për periudhën 2019-2021 rezulton se format me të shpeshta të korrupsionit në Kosovë janë;

- Keqpërdorimi i pozitës zyrtare
- Marrja dhe dhënia e ryshfetit
- Konflikti i interesit
- Nepotizmi

Edhe për këtë periudhë kohore 2019-2021 bazuar në analizat, hetimet, vlerësimet vendore dhe ndërkombëtare, sondazheve të ndryshme, më së shumti korrupsioni është i paraqitur në institucionet publike ku ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike. Rastet më të shpeshta të paraqitjes së korrupsionit janë në:

- Prokurimin publik
- Shëndetësi
- Subvencionet dhe grantet qeveritare
- Dhënia e lejeve dhe licencave
- Sektorin e ndërtimeve
- Sektorin e privatizimeve
- Ndërmarrjet publike.

Në fushën e prokurimit publik nga analiza e përgjithshme në këtë sektor rezulton se korrupsioni manifestohet përmes kurdisjes së tenderëve përkatësisht përshtatjes së specifikave të tenderit për operator të ndryshëm ekonomik, marrja e mitos si rezultat i

shpërblimit me kontratë, moszbatim i duhur i kushteve të kontratës apo kryerja e punëve në mënyrë jocilësore.

Në fushën e shëndetësisë po ashtu korrupsioni manifestohet përmes kontratave të furnizimit me barna me çmime shumë më të larta të produkteve se sa çmimi në treg, e po ashtu edhe marrjes së mitos për ofrimin e shërbimeve mjekësore.

Në fushën e subvencioneve dhe granteve qeveritare nga analiza e rasteve që janë trajtuar korrupsioni shfaqet përmes bashkëpunimit ndërmjet zyrtarëve publik me përfituesit e subvencioneve apo granteve, duke krijuar situata të shpërblimit me subvencione individëve që nuk kanë interes të drejtpërdrejtë të përmbushjes së subvencionit, por duke krijuar dokumentacion fiktiv lidhur me investimin në bujqësi me qëllim të përfitimit të subvencionit, shumën e të cilit e ndajnë me personat zyrtarë e që në fakt përmbushja e investimit për çka është fituar subvencioni nuk ka ndodhur fare.

Në fushën e dhënies së lejeve dhe licencave, korrupsioni manifestohet përmes marrjes së lejes dhe licencave për veprimtari të ndryshme me anë të mitos, pa i plotësuar kriteret ligjore.

Në fushën e ndërtimeve, korrupsioni manifestohet në dhënien e lejeve të ndërtimit investitorit pa i plotësuar kriteret për ndërtim, por ka edhe raste kur jepet mito përkundër faktit se janë plotësuar kriteret përkatëse.

Në sektorin e privatizimit, korrupsioni manifestohet në procesin e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe pronës publike në përgjithësi, duke privatizuar me çmime jo konkurruese e po ashtu përmes mos mbikëqyrjes së duhur të kontratave të privatizimit.

Për periudhën 2019-2021 në bazë të rasteve të trajtuara nga Policia e Kosovës por edhe duke u bazuar në raportet e ndryshme si nga Këshilli i Evropës, organizata të tjera si Transparency International¹³, Kosova renditet në vendet me prezencë të lartë të korrupsionit, megjithatë në të gjitha këto raporte konstatohet një përparim i lehtë i Kosovës në fushën kundër korrupsionit. Situata me korrupsionin në Kosovë vlerësohet të jetë përafërsisht e ngjashme me atë të vendeve fqinje dhe ndër faktorët e përgjithshëm që favorizojnë prezencën e korrupsionit ndërlidhen kryesisht me tranzicionin e gjatë politik, mungesën e zhvillimit ekonomik në vend, kushtet e përgjithshme socio-ekonomike etj.

Një konstatim lidhur me përparimin e lehtë të Kosovës në fushën kundër korrupsionit gjatë vitit 2021 nga ana e Transparency International thuhet se Kosova ka shënuar përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, duke u vlerësuar me 39 pikë (tri më

¹³ Vlerësim i organizatës ndërkombëtare "Transparency International": <https://www.dw.com/sq/reagime-dhe-rekomandime-p%C3%ABr-kosov%C3%ABn-dhe-luft%C3%ABn-kund%C3%ABr-korrupsionit/a-60552982>

shumë sesa vitin e kaluar) në indeksin e perceptimit të korrupsionit për vitin 2021. Në këtë raport, Kosova renditet në pozicion më të mirë se disa vende të rajonit si: Shqipëria me 35 pikë, Bosnja-Hercegovina me 35 pikë dhe Serbia me 38 pikë.

Duke iu referuar raporteve të Transparency International mbi shtetet e Ballkanit, sipas këtij vlerësimi të gjitha këto vende karakterizohen nga një nivel i lartë i korrupsionit. Karakteristikat e përbashkëta të korrupsionit në këto vende janë ndërrimi i sistemeve politike, tranzicionet e gjata demokratike, papunësia e lartë dhe përpjekja për ta zvogëluar atë nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës në sektorët publik, pagat e ulëta të punësuarve në sektorët publik dhe niveli i lartë i papunësisë.

Në Raportin e Progresit të, KE¹⁴-së për Kosovën 2021, theksohet se Kosova ka bërë përparim të kufizuar në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke vënë theksin se duhet shtuar përpjekjet për hetime më aktive, vendime përfundimtare gjyqësore dhe konfiskim përfundimtar të pasurive të paligjshme.

Policia e Kosovës ka trajtuar dhe proceduar në Prokurorinë kompetente këto raste të korrupsionit siç pasqyrohen në tabelë:

Statistikat për veprat penale të Korrupsionit	2019	2020	2021
Raste të hapura	149	78	156
Kallëzime penale me kryes të njohur	136	60	167
Numri i personave të arrestuar	70	29	162
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	341	141	468

Statistikat për veprat penale të korrupsionit 2019-2021

Nga analizimi i statistikave të rezultateve të DHKEK, me ato të raportit paraprak, kemi një trend në rritje të numrit të kallëzimeve penale, për dallim nga periudha paraprake ka një përqendrim më të madh të aktiviteteve hetimore dhe kallëzimeve penale në fushën e prokurimit publik, në sektorin e shëndetësisë dhe në fushën e granteve dhe subvencioneve qeveritare.

Statistikat zyrtare të Policisë së Kosovës tregojnë për një ngritje në procedimin e lëndëve të korrupsionit, kallëzimeve penale dhe arrestimin e personave.

¹⁴ Kosovo* 2021 Report

Gjatë këtyre tri viteve Policia e Kosovës përmes dy mekanizmave të saj Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit dhe Njësisë së Veçantë të Hetimit në Luftën kundër Korrupsionit ka qenë e fokusuar në parandalimin, identifikimin dhe luftimin e veprave korruptive të nivelit të lartë me fokus të veçantë në proceset e tenderimit, privatizimit, sistemin financiar dhe në institucionet e tjera qeveritare dhe të subjekteve ekonomike me qëllim të ruajtjes së buxhetit të shtetit.

Janë identifikuar fushat kritike të mundshme për kryerje të veprimeve korruptive me pasoja serioze për buxhetin e Kosovës.

Në këtë periudhë, veçanërisht pas fillimit të pandemisë COVID-19 kemi shfaqjen e një forme me të veçantë të dyshimeve për keqpërdorime në fushën e prokurimit publik duke aplikuar procedura emergjente të prokurimit. Prokurimi publik në masë të madhe është zhvilluar në procedura emergjente e cila ka shkaktuar uljen e transparencës institucionale duke rritur mundësitë për korrupsion.

Përgjatë kësaj periudhe kohore 2019-2021, institucionet e Kosovës, përkatësisht Policia e Kosovës ka zhvilluar aktivitete të shumta hetimore për rastet e korrupsionit, ku ka pasur hetime intensive në fushën e prokurimit publik, në fushën e subvencione dhe granteve qeveritare për bujqësi, farmaci dhe shëndetësisë në përgjithësi etj.

Në fushat e sipërcekura janë arritur disa rezultate të cilat dëshmojnë nga lëndët e proceduara në prokurori për trajtim të mëtejshëm, ndërsa në disa raste kemi edhe përfundim të procedurës me aktgjykime dënuese.

Nga rastet e hetuara nga NJVH-ja, sa i përket korrupsionit të profilit të lartë, gjatë periudhës 2019-2021, nga PSRK janë ngritur 19 aktakuza për veprimtarinë, madhësinë, përfitimet, mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Sipas statistikave të NJVH-së, gjatë periudhës kohore 2019-2021, janë trajtuar dhe proceduar në prokuroritë kompetente këto raste të korrupsionit siç pasqyrohen në tabelën e mëposhtme të krahasuara me vitet e mëparshme 2016-2018.

Rastet 2016-2018 dhe 2019-2021 nga NJVH						
Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Raste	27	19	10	21	9	24

Rastet 2016-2018 dhe 2019-2021 nga NJVH

Në vitin 2021 në NJVH janë iniciuar për hetime 24 raste të reja që kanë të bëjnë me veprat penale keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe krimet të organizuar, janë bërë 7 kallëzime penale kundër 33 të dyshuarve si dhe janë sekuestruar 1,900,000.00 euro.

Kallëzimet penale dhe numri i të dyshuarve për korrupsion 2016-2018 dhe 2019-2021 NJHV						
Vitet	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i kallëzimeve penale	2	6	6	12	5	7
Nr. i të dyshuarve me kallëzim penal	9	14	109	56	32	33

Tabela me statistika për kallëzimet penale dhe numri i të dyshuar për korrupsion 2016-2018 dhe 2019-2021 NJHV

Në aspektin e infrastrukturës ligjore Republika e Kosovës konsiderohet se ka legjislacion të avancuar për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe ka të hartuara dy strategji: Strategjia kundër korrupsionit për vitin 2021-2023 dhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2022.

Në të gjitha vlerësimet vendore dhe ndërkombëtare vlerësohet se në aspektin e ligjeve kundër korrupsion Kosova është në përputhshmëri me standardet me të larta ndërkombëtare, mirëpo ngecjet evidentohen në fazën e zbatimit të ligjeve përkatësisht në numrin e vogël të aktgjykimeve dënuese dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

Shpëlarja e parasë

Sikurse edhe në çdo vend tjetër edhe në Kosovë mund të konkludojmë se më së shumti paratë e shpëlarja rrjedhin nga aktivitetet kriminale siç janë: trafikimi me drogë, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, prostitucioni, kontrabanda, ryshfeti, etj.

Institucionet e Kosovës me gjithë vështirësitë ekzistuese janë të përkushtuara që me të gjithë mekanizmat ligjor dhe institucional ta luftojnë këtë dukuri negative të shoqërisë dhe për këtë arsye janë krijuar institucione dhe norma juridike me qëllim të parandalimit dhe luftimit të veprës penale të pastrimit të parave.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të shpëlarjes së parasë, Kosova ka në funksion edhe Njësinë për Inteligjencë Financiare e cila monitoron, analizon dhe adreson raporte mbi transaksionet e dyshimta bankare.

Gjithashtu në kuadër të Policisë së Kosovës, ekzistojnë mekanizma të veçantë të cilët merren me luftimin e shpëlarjes së parasë.

Dyshohet që shpëlarja e parave kryesisht orientohet në veprimtaritë ekonomike të poshtëshënuara:

- a) Investime në prona të paluajtshme,
- b) Ndërtimtari,
- c) Hoteleri,
- d) Vetura,
- e) Hapjen e veprimtarive të ndryshme biznesore apo
- f) Vazhdimin e bizneseve aktuale,
- g) Shpenzime jetësore të luksit,
- h) Kriptoalutat

Në vijim i paraqesim, statistikat e rasteve të pastrimit të parave të cilat janë hetuar nga Policia e Kosovës gjegjësisht, DHKEK-Sektori i Hetimeve Financiare për periudhat 2019, 2020, dhe 2021.

Statistikat për veprat penale të Pastrimit të Parasë	2019	2020	2021
Raste të hapura	4	1	6
Kallëzime penale me kryes të njohur	4	1	4
Numri i personave të arrestuar	1	0	13
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	9	3	14

Tabela statistikore për veprat penale të Pastrimit të Parasë 2019 - 2021

KONTRABANDA ME MALLRA

Në Kosovë dhe në vendet e rajonit ende ekzistojnë mundësitë e hapura për tregtinë e paligjshme dhe kontrabandën e mallrave të akcizës (alkool, kafe, cigare, derivate të naftës, produkte farmaceutike etj.), si dhe mallra të tjera të falsifikuara.

Sipas të dhënave në dispozicion grupet e organizuara të kontrabandës me mallra operojnë nëpër të gjithë territorin e Kosovës, me theks të veçantë aktivitetin e tyre e kanë të shtrirë me shumë në Rajonin e Mitrovicës, në Rajonin e Pejës dhe në Rajonin e Gjilanit.

Zhvillime të aktiviteteve të kontrabandës ka pasur dhe vazhdon të ketë edhe në rajonet e tjera si Rajoni i Prizrenit, përgjatë brezit kufitar me Shqipëri dhe zona e Podujevës, ku kontrabandohen mallra të ndryshme.

Grupe të organizuara kontrabandojnë mallra të llojllojshme, por në veçanti janë të njohura për kontrabandim të produkteve: cigaret/duhani, derivatet e naftës dhe vajrat, tekstili, produktet e ndryshme ushqimore, etj. Personat e caktuar që i takojnë këtyre grupeve kriminale, herë pas here lëvizin nga një grup në tjetrin, varësisht prej mallrave që i kontrabandojnë por edhe për ndonjë qëllim tjetër.

Kontrabanda me mallra është shumë më e orientuar në Veri të vendit, ku edhe grupet e krimit të organizuar të kontrabandës janë shumë më të gjera dhe të avancuara, të cilat nuk përjashtojnë edhe përdorimin e dhunës me qëllim të arritjes së qëllimeve të tyre.

Grupet e krimit të organizuar të kontrabandës me mallra, synojnë që mallrat e kontrabanduara t'i destinonjë në tërë tregun kosovar, shpeshherë edhe në marrëveshje me tregtarët, duke i përzier me mallrat ekzistuese të ligjshme.

Mallrat e kontrabanduara, meqenëse nuk iu nënshtrohen tarifave doganore dhe atyre të akcizës, të njëjtat mund të gjenden në tregun e Kosovës, me çmime më të lira, duke ngritur edhe interesimin kryesisht të bizneseve që të furnizohen me këto mallra, duke dëmtuar në masë të madhe buxhetin e vendit.

Megjithatë më të rrezikuarit nga dukuria e kontrabandimit mbeten qytetarët, të cilët rrezikojnë të blejnë mallra të kontrabanduara me çmimin e njëjtë që do paguanin edhe për mallrat e importuara në mënyrë të ligjshme, por që mallrat e kontrabanduara nuk iu nënshtrohen analizave të cilësisë.

Gjithashtu, duke marrë parasysh që kontrabanduesit e mallrave nuk iu përmbahen kushteve të transportit dhe ruajtjes së mallrave, veçanërisht të atyre ushqimore dhe farmaceutike, këto mallra janë të rrezikshme për shëndetin dhe jetën e konsumatorëve.

Gjatë periudhës 2019-2021 nga Dogana e Kosovës, përkatësisht nga Sektori i Hetimeve janë evidentuar 312 raste të kallëzimeve penale kundër 361 personave të dyshuar dhe vlera e mallrave të sekuestruara kap vlerën 5,782,006.40 €. Detajet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Hetimet	Numri i kallëzimeve penale	Numri i personave të kallëzuar	Shmangiet sipas kallëzimeve penale	Vlera e mallrave të sekuestruara
2019	117	150	2,978,286.11 €	2,021,968.98 €
2020	111	119	2,893,585.56 €	2,383,855.83 €
2021	84	92	2,714,962.41 €	1,376,181.59
Totali	312	361	8,586,834.08 €	5,782,006.40 €

Tabela statistikore për numrin e kallëzimeve penale, personave të kallëzuar, shmangiet sipas kallëzimeve penale dhe vlera e mallit të sekuestruar nëpër vite

Kontrabandimi i produkteve të duhanit

Kontrabandimi i cigareve - gjatë viteve të fundit është shfaqur dukuria e kontrabandimit të cigareve të brendeve jo të njohura apo ndryshe të quajtura “No Name Brands”, të cilat zakonisht prodhohen në Kinë, Bullgari, Serbi por edhe në vendet e tjera. Kontrabandimi i cigareve ndodh edhe nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Mënyrat e kontrabandimit të cigareve janë bërë si në vijim: Cigaret janë kontrabanduar nga Zonat e Lira Tregtare (Free Trade Zone) në Serbi për në Kosovë duke bërë deklarime jo të sakta apo duke deklaruar mallra të tjera në vend të cigareve. Më një efikasitet të përcjelljes përmes sistemeve të qarkullimit të mallrave është vërejtur një dukuri e tillë dhe është eliminuar brenda një kohe të shkurtër.

Cigaret janë kontrabanduar nga Mali i Zi për në Kosovë, përmes rrugëve ilegale, duke përdorur për transport mjetet e veçanta për terrene malore dhe duke përdorur kafshët si kuajt dhe gomarët, si formë tjetër e transportit të mallrave kontrabandë. Cigaret që më së shumti janë kontrabanduar përmes kësaj mënyre janë brendet jo-të njohura (no name brands) si dhe cigaret e brendeve ‘Prestige dhe Trokadero’. Identifikimi i këtyre dërgesave me cigare ka qenë dhe vazhdon të jetë mjaftë i vështirë për arsye se këto dërgesa nuk paraqiten fare si eksporte nga Mali i Zi për në Kosovë.

Kontrabandimi i cigareve bëhet edhe nga Maqedonia e Veriut. Arsye pse ndodh kontrabandimi i cigareve nga ky vend është niveli taksave më të ulëta se në vendin tonë dhe kjo ka nxitur interesin e kontrabandistëve, sidomos atyre të rajonit të lindjes së Kosovës, që të kontrabandojnë mallin e tillë në Kosovë, ku zakonisht kanë kontrabanduar cigare të brendeve ‘Chesterfield’ dhe ‘Marlboro’.

Kontrabandimi i cigareve përmes Shqipërisë për në Kosovë kohëve të fundit ka shënuar rritje sidomos të brendit 'Regina'.

Kontrabandimi i duhanit të grirë dhe duhanit gjethe - duke e pasur parasysh se importin e duhanit të papërpunuar (duhanit në fletë) mund të bëjnë vetëm kompanitë e licencuara për prodhim, është shfaqur interesimi nga kontrabandistët e ndryshëm për kontrabandimin e duhanit të papërpunuar nga Maqedonia dhe Shqipëria. Kontrabandimi i duhanit bëhet përmes rrugëve të ndryshme ilegale përgjatë vijës së gjelbër që e kufizojnë Kosovën me këto dy shteteve. Duhani i papërpunuar nuk ka fare normë të akcizës dhe në shumicën e rasteve kontrabandohet në gjendje të tillë. Duhani i papërpunuar i sjellë si kontrabandë në Kosovë përpunohet (prihet/grihet) nëpër shtëpitë apo punëtoritë e ndryshme të kontrabandistëve. Kjo dukuri e kontrabandimit të duhanit të papërpunuar ka qenë sfidë e viteve të fundit.

Vlen të cekim se vitin e fundit kemi pasur dyfishim të sasisë së konfiskuar të duhanit të grirë dhe duhanit gjethe në raport me dy vitet paraprake, që mund të ndërlihdet edhe me ngritjen e çmimit të cigareve dhe duhanit në Kosovë.

Megjithatë shqetësues mbetet fakti që duhani i grirë dhe duhani gjethe, përveçse një sasi e saj është e destinuar për konsum, pjesa dërmuese dyshohet se është e destinuar me qëllime të përpunimit, si dhe ambalazhimit të falsifikuar të cigareve të brendeve të njohura.

Kontrabandimi i duhanit nargjile - kohëve të fundit, me rastin e hapjeve të një numri të madh të shisha-bareve thuhet në tërë territorin e Kosovës, është shfaqur edhe dukuria e kontrabandimit të duhanit 'nargjile'. Kontrabandimi i duhanit 'nargjile' bëhet zakonisht përmes personave fizik të cilët e sjellin në Kosovë me autobusët e linjave nga Turqia dhe nga Gjermania.

Si rezultat i kontrollimeve të shpeshta në kufi, ka pasur shenja pozitive ku bizneset kanë filluar dhe janë licencuar për importin e mallit të tillë, megjithatë në vitin e fundit 2021 kemi pasur rritje të rasteve të konfiskimit të duhanit 'nargjile'.

Malli\Viti	2019	2020	2021
Cigare	5,596,700 copë	1,153,960 copë	4,410,760 copë
Duhan i grirë	2,327 kg.	86.7 kg.	3,607 kg.
Duhan gjethe	4,231 kg	1030 kg	7,600 kg.
Duhan nargjile	182 kg	266.15 kg	2,310 kg.
Filtera për cigare	3,453,600 copë	790,000 copë	1,000,000 copë

Tabela statistikore për sekuestrimin e duhanit 2019 - 2021

Kontrabandimi i derivateve të naftës dhe vajrave

Dukuria e kontrabandimit të derivateve të naftës ka qenë shumë e theksuar qysh prej përfundimit të luftës në Kosovë.

Derivatet e naftës zakonisht janë kontrabanduar nga Serbia për në Kosovë përmes rrugëve ilegale përgjatë vijës së gjelbër dhe të njëjtat janë deponuar në pika karburanti të ndryshme ilegale të derivateve të naftës në Veriun e Kosovës.

Pastaj, nga këto pika ilegale të deponimit dhe shitjes së derivateve, kontrabandistët e ndryshëm nga pjesët e tjera të vendit i kanë ngarkuar maunat e tyre dhe mjetet e tjera të transportit të cilat kanë pasur rezervuare të montuara enkas për këtë qëllim.

Derivatet e naftës zakonisht janë kontrabanduar nga grupet e organizuara kriminale. Këto grupe kriminale ngarkesat me derivate të kontrabanduara i përcjellin me automjete të udhëtarëve me qëllim të sigurimit dhe informimit të grupit për situatën përgjatë rrugës, si dhe për prezencën e autoriteteve shtetërore si Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Sa i përket vajrave motorike, kontrabandimi i tyre bëhet kryesisht nga Serbia, por edhe nga Maqedonia e Veriut. Vajrat motorike që kontrabandohen nga Serbia deponohen në pjesën veriore të Kosovës dhe pastaj shpërndahen nëpër pjesë tjera të territorit të Kosovës.

Vajrat që kontrabandohen nga Maqedonia e Veriut zakonisht prodhohen në Maqedoni dhe janë të brendeve jo shumë të njohura, por kemi raste kur janë kontrabanduar edhe vajra të falsifikuara të brendeve të njohura.

Kontrabandimi i vajrave bëhet përmes rrugëve ilegale përgjatë vijës së gjelbër me Maqedoninë e Veriut, duke përdorur mjete të ndryshme të transportit si furgonë, komioneta të vogla dhe traktorë.

Vlen të cekim se dukuria e kontrabandimit të derivateve dhe vajrave ka qenë më pak e theksuar gjatë tri viteve të fundit 2019-2021, kjo si rezultat i çmimit thuajse të njëjtë në të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit.

Kontrabandimi i tekstilit

Tekstili kontrabandohet kryesisht nga Maqedonia e Veriut. Dogana e Kosovës ka bërë përpjekjet maksimale që të bëjë vlerësime sa më reale të mallrave që importohen, e në veçanti edhe të tekstilit dhe po ashtu i ka kushtuar rëndësi mashtrimeve me mallrat e falsifikuara - DPI ¹⁵dhe si rezultat është shfaqur interesimi i kontrabandimit të tekstilit nga Maqedonia e Veriut, ku kontrollet janë më sipërfaqësore.

Arsyeja pse deri me tani ka ndodhur kontrabandimi i tekstilit nga Maqedonia është çmimi apo vlerësimi me i ulët i tekstilit që bëhet nga Dogana e Maqedonisë së Veriut. Kjo ka nxitur që kontrabandistët e ndryshëm nga Kosova të zhdoganojnë mallin në Maqedoni, e pastaj nga atje përmes rrugëve ilegale të fusin tekstilin në Kosovë. Po ashtu, rrugët dhe mënyrat e kontrabandimit të tekstilit janë të njëjta sikur edhe e produkteve të tjera dhe bëhet përmes rrugëve ilegale përgjatë vijës së gjelbër me Maqedoninë e Veriut, duke përdorur mjete të ndryshme të transportit si furgonë,

Malli\Viti	2019	2020	2021
Tekstil i ndryshëm	7,786 copë	8,708 copë	6,886 copë

Tabela statistikore lidhur me sekuestrimin e tekstilit

komioneta të vogla dhe traktorë.

Kontrabandimi i pijeve alkoolike dhe joalkoolike

Gjatë periudhës kohore 2019-2021 kontrabanda e pijeve alkoolike dhe joalkoolike ka vazhduar gati me intensitet të njëjtë sikurse edhe viteve të mëparshme, në veçanti gjatë periudhës kur ka qenë në fuqi taksa 100% për produktet me origjinë nga Serbia.

Kontrabanda e pijeve bëhet kryesisht nga Serbia. Rrugët dhe mënyra e kontrabandimit të pijeve alkoolike dhe joalkoolike është e njëjtë si edhe e produkteve të tjera dhe bëhet përmes rrugëve ilegale përgjatë vijës së gjelbër me Serbinë, më konkretisht përgjatë brezit kufitar në Veri të Kosovës.

Transporti i mallrave të kontrabanduara është bërë duke përdorur mjete të ndryshme të transportit si furgonë, komioneta të vogla dhe automjete të udhëtarëve. Kontrabandimi i tyre në rastet më të shpeshta është bërë nga persona të ndryshëm fizik dhe në raste më të rralla kontrabandimi është bërë nga grupet e organizuara kriminale të kontrabandimit me mallra.

Janë evidentuar rastet të shumta të kontrabandimit të pijeve, ku personat e ndryshëm fizik janë ndaluar duke transportuar pijet e kontrabanduara përgjatë rrugëve magjistrale Mitrovicë – Prishtinë dhe Mitrovicë – Pejë.

¹⁵ E Drejta e Pronësisë Intelektuale

Malli\ Viti	2019	2020	2021
Pije alkoolike	13,086 litra	2,125 litra	11,145 litra
Pije joalkoolike	12,148 litra	30,061 litra	25,900 litra

Tabela statistikore lidhur me sekuestrimin e pijeve alkoolike dhe joalkoolike nëpër vite

Rrugët e kontrabandimit të mallrave të konsumit të përgjithshëm

Gjatë periudhës 2019 – 2021 kontrabanda me mallra të përgjithshme kryesisht është e fokusuar nga Serbia, përmes rrugëve ilegale, apo rrugëve dhe pikë kalimeve kufitare të cilat nuk janë të destinuara për qarkullimin e mallrave, ndërsa ndër rajonet më të prekura nga kontrabanda është veriu i Kosovës, ku grupet e organizuara kriminale kanë hapur rrugë ilegale, duke shmangur transportimin e mallrave përmes pikë kalimeve zyrtare kufitare. Këto rrugë ilegale janë hapur në zonën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, ku janë identifikuar disa rrugë të tilla.

Për qëllime të kontrabandimit, kontrabandistët përdorin edhe liqenin e Gazivodës, duke lëvizur mallrat edhe me barka.

Kontrabanda në kufirin me Serbinë zhvillohet edhe përmes rrugëve ilegale në zonat e Podujevës, Gjilanit dhe Kamenicës, ku janë identifikuar disa rrugë që shfrytëzohen nga kontrabanduesit e mallrave.

Kontrabanda në kufirin me Maqedoninë e Veriut, kryesisht realizohet përmes disa rrugëve ilegale të identifikuara, shumica prej të cilave në afërsi të pikë kalimit kufitar të Hanit të Elezit.

Kontrabanda me Shqipërinë, kryesisht realizohet përmes disa rrugëve ilegale, duke përfshirë zonën malore që lidh Dragashin me Shqipërinë, që për shkak të pozitës gjeografike dhe kushteve atmosferike zakonisht bëhet gjatë stinës së verës.

Kontrabanda me Shqipërinë realizohet edhe përmes barkave, duke përdorur liqenin e Vërmicës për të kaluar mallrat nga njëra anë e kufirit në anën tjetër.

VEPRAT PENALE QË NDËRLIDHEN ME TË DREJTËN E AUTORIT DHE MALLRAT E FALSIFIKUARA

Në Kosovë vazhdon të ketë probleme me shkeljen e të drejtave të autorit, ndonëse institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë masa të shumta për të luftuar këto shkelje, ende ndodh shitja dhe prodhimi i veprave kopje.

Edhe pse viteve të fundit është identifikuar një trend pozitiv i angazhimit të institucioneve të Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e piraterisë, mallrave të falsifikuara dhe veprave të tjera që ndërlidhen me të drejtën e autorit, megjithatë kjo dukuri edhe më tutje vazhdon të mbetet sfidë për institucionet e vendit.

Ndër sfidat më të theksuara të kësaj natyre janë mallrat e falsifikuara, të cilat edhe më tutje vazhdojnë të jenë lehtësisht të qasshme në treg. Ndër faktorët kryesor që ndikojnë drejtpërsëdrejti në sasinë e mallrave të falsifikuara, veçanërisht atyre të importuara është kërkesa e konsumatorit dhe fuqia blerëse, duke i bërë mallrat e falsifikuara, kryesisht të brendeve më të njohura të jenë mjaft atraktive në tregun kosovar.

Markat më të shtrenjta botërore mund t'i gesh në Kosovë me një çmim shumë të lirë. Kjo po ndodh për faktin se produkte të shumta të markave më të njohura falsifikohen dhe hyjnë në Kosovë, e të cilat vijnë nga disa shtete që njihen për prodhime që ilegalisht mbajnë etiketa të brendeve të njohura ndërkombëtarisht.

Dogana e Kosovës¹⁶ herë pas here, ka zhvilluar operacione nën mbikëqyrje doganore dhe nën përgjegjësinë e bartësit të së drejtës ka konfiskuar dhe asgjësuar mallrat: tekstil dhe atlete të markave të njohura botërore si: "Zara", "Adidas", "Nike", "Hugo Boss", "Lacoste", "Channel", "Puma", "Prada", "Gucci", "Gant", "Polo Ralph Lauren", "Tommy Hilfiger", etj., mallra këto të konfirmuara nga bartësi i së drejtës se janë të

<i>Dogana e Kosovës</i>	2019	2020	2021
Rastet e mallrave të konfiskuara (numër)	22	38	61
Sasia e mallrave të konfiskuara (copë)	46,127	75,748	103,757
Vlera e mallrave të konfiskuara (€)	384,344	262,511	153,473

Tabela statistikore nga Dogana e Kosovës lidhur me rastet, sasinë dhe vlerën e mallrave të konfiskuara 2019-2021

falsifikuara.

Mallrat e falsifikuara të konfiskuara në tregun e Kosovës janë disa dhjetëra lloje, mirëpo mallrat e falsifikuara të cilat më së shumti gjenden në tregjet kosovare janë: "Nike", "Adidas", "Tommy Hilfiger", "Hugo Boss", "Chanel", "Gucci", "Apple" dhe "Lacoste" të cilat përbëjnë 50% e mallrave të përgjithshme të falsifikuara.

¹⁶ <https://www.njeshi.com/dogana-e-kosoves-konfiskoi-mallra-te-falsifikuara-te-markave-te-njohura/>

Lloji i brendit të mallrave të falsifikuara	2019	2020	2021	Totali në %
Nike	9.35%	15.24%	22.22%	13.49%
Adidas	10.79%	10.48%	17.78%	11.76%
Tommy Hilfiger	3.60%	4.76%	6.67%	4.50%
Hugo Boss	2.16%	6.67%	6.67%	4.50%
Channel	2.88%	5.71%	6.67%	4.50%
Gucci	7.19%	1.90%	2.22%	4.50%
Apple	3.60%	4.76%	4.44%	4.15%
Lacoste	3.60%	1.90%	2.22%	2.77%

Tabela statistikore për llojet e brendeve të mallrave të falsifikuara 2019-2021

Këto mallra janë duke u shitur nëpër tregje dhe në disa nga dyqanet për shitjen e veshmbathjeve. Ky lloj krimi në Kosovë nuk është shumë i raportuar për shkak të disa shkaqeve, e që shkak kryesor është mosnjohja e mjaftueshme e këtyre mallrave nga ana e konsumatorëve, pastaj këto mallra në treg gjenden me një çmim më të volitshëm dhe konsumatorët mendojnë se me çmime më të ulëta kanë në posedim të tyre marka të njohura dhe të shtrenjta.

Nga mallrat e falsifikuara dëmtohen të hyrat shtetërore pasi që bartësit e tyre gjatë të gjithë procesit ju ikin procedurave si në deklarimin e mallit në kufi ashtu edhe gjatë tatimit dhe shitjes, dhe njëkohësisht nga kjo dukuri dëmtohen edhe bizneset serioze të cilat punë primare e kanë importimin dhe shitjen e mallrave origjinale, por më së shumti dëmtohen vetë prodhuesit legjitim sepse atyre ju bëhet kundër reklamë me mallrat e falsifikuara.

Mallrat kryesore të falsifikuara të cilat janë vënë në shitje në treg janë zakonisht veshmbathje, tekstil dhe pajisje të ndryshme elektronike si telefona celularë. Si pajisje elektronike të falsifikuara të vëna në qarkullim janë telefonat celularë të markave "IPHONE" dhe "SAMSUNG" të cilat dyshohen se hyjnë në Kosovë duke ju shmangur kontrolleve dhe procedurave doganore.

Mbi 50% e mallrave të falsifikuara janë (blank) pa origjinë, ndërsa sa i përket origjinës Kina vazhdon të jetë shteti që më së shumti eksporton mallra false, pastaj pas Kinës edhe disa mallra nga Turqia gjenden në tregun e Kosovës e të cilat kryesisht janë të tekstilit.

Vendi i origjinës së mallrave të falsifikuara	2019	2020	2021	Totali në %
(Blank)* pa origjinë ose nuk dihet origjina e mallit	61.05%	36.19%	51.11%	53.72%
China	28.09%	18.10%	15.56%	24.22%
Turkiye	5.24%	33.33%	28.89%	14.87%
Kosovo	0.75%	7.62%	0.00%	2.40%
Italy	3.00%	0.00%	0.00%	1.92%
Albania	1.50%	1.90%	0.00%	1.44%
Bangladesh	0.00%	1.90%	2.22%	0.72%
Hong Kong	0.00%	0.95%	0.00%	0.24%
Japan	0.37%	0.00%	0.00%	0.24%
Serbia	0.00%	0.00%	2.22%	0.24%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Mallrat e falsifikuara në Kosovë sipas origjinës 2019-2021

Aktualisht në Kosovë nuk ka informacione se është aktive ndonjë fabrikë ose minifabrikë ilegale në të cilën janë duke u prodhuar/imituar mallrat të pronësisë intelektuale, por nuk përjashtohet mundësia e ekzistimit të ndonjë prodhuesi ilegal duke marrë për bazë faktin se mallra të tilla gjenden në treg herë pas here por edhe duke u bazuar në të kaluarën e afërt ku janë hasur fabrika duke prodhuar mallra të falsifikuara.

Viteve të fundit në Kosovë janë identifikuar dhe janë zhvilluar kontrollime dhe procedura penale ndaj disa prodhuesve të disa prej brendeve të njohura botërore si dhe janë konfiskuar mallra të falsifikuara të markave “NIKE”, “LEVIS”, “ADIDAS”, “REEBOK”, “PUMA”, “PRADA”.

Mallrat e falsifikuara mund të paraqesin rrezik për shëndetin e konsumatorit pasi që materialet me të cilat janë të punuara këto mallra nuk i përmbajnë cilësitë dhe kriteret e duhura dhe për shkak se nuk ju nënshtrohen kriterëve të parapara mund të kenë në përmbajtje materiale të dëmshme për shëndetin.

Veprat penale kundër autorësisë dhe mallrave të falsifikuara kryesisht përfshijnë bizneset legale, të cilat për qëllime të përfitimit dhe shpeshherë duke përfituar nga zbrazësitë ligjore, apo edhe nga zbatimi i akteve normative, përfshihen në këto veprimtari.

Ndër rajonet më të prekura nga qarkullimi i mallrave të falsifikuara, përkatësisht nga piratëria është Veriu i Kosovës.

Gjatë viteve të fundit është identifikuar një trend në rritje i vënies në qarkullim dhe shitjes së produkteve të falsifikuara 'online', ku janë të përfshirë individ të caktuar të cilët promovojnë produktet e tyre, kryesisht përmes rrjeteve sociale, por që nuk disponojnë me ndonjë biznes të regjistruar apo edhe ambiente fizike që mund të frekuentohen nga ana e konsumatorëve.

Përveç mallrave të falsifikuara, Institucionet e Republikës së Kosovës janë duke u ballafaquar edhe me trendin e piratërisë përmes internetit, e cila kryesisht është e orientuar në piratërinë 'online', përkatësisht me qëllime përfitimi, vejnë në dispozicion për qytetarët platforma të ndryshme të filmave 'online', të qasshme edhe për shkarkim të paautorizuar, duke përfshirë edhe filmat nga platforma 'Netflix'.

Gjithashtu problematike mbeten edhe platformat e ndryshme të ofrimit të shërbimeve të kanaleve televizive përmes aplikacioneve të ndryshme të paautorizuara, duke përfshirë këtu platforma për shkarkim në sistemin 'android' pa pagesë, por edhe platforma më të avancuara që përfshijnë një mënyrë të abonimit mujor për qasje të paautorizuar dhe të pa limituar në kanale televizive, që përfshijnë kanalet e të gjithë abonentëve legjitim vendor por edhe të kanaleve ndërkombëtare.

TRAFIKIMI ME ARMË

Trafikimi me armë në Kosovë dhe në vendet e Ballkanit është dukuri e dekadave për shkak të faktorëve të shumtë, ndër to luftërat në ish Jugosllavi, rënia e sistemeve komuniste, tranzicionet dhe vakumet e krijuara në ushtritë e disa vendeve të dala nga këto sisteme, trazirat e mirënjohura të vitit 1997 në Shqipëri hapja dhe vjedhja e depove të armatimeve, si dhe lufta e fundit në Kosovë, kanë bërë që shumë armë të përfundojnë në duart e popullsisë në Kosovë.

Edhe pas përfundimit të luftës grupe të ndryshme kriminale të kontrabandës së armëve kanë blerë dhe kanë shitur armë në vendet e rajonit si dhe në disa nga vendet e Evropës Perëndimore.

Në kontrabandimin me armë grupet kriminale kosovare bashkëpunojnë ngushtë njëra me tjetrën, kryesisht janë grupe të vogla të cilat funksionojnë duke u bazuar në lidhjet familjare të drejtuesve të këtyre grupeve kriminale, me tendenca për t'u zgjeruar sipas nevojës.

Sipas të dhënave policore, armët e trafikuar në Kosovë, janë duke u përdorur për kryerjen e veprave të ndryshme penale si: vrasje, grabitje, kanosje, plagosje etj. dhe kryesisht përdoren nga individ të veçantë dhe jo grupe të organizuara kriminale.

Viteve të fundit, shqetësues është fakti se disa kriminelë gjatë kryerjes së aktiviteteve kriminale kanë përdorur edhe armët legale të cilat i kanë pasur me leje. Po ashtu, ka pasur disa raste, ku disa depo apo shitore për shitjen e armëve janë thyer nga të dyshuarit, të cilët kanë vjedhur armë në sasi të mëdha të cilat kanë përfunduar në tregun ilegal.

Në shtetet fqinje si Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut, janë gjetur armë që janë vjedhur në Kosovë, por edhe në vendin tonë janë gjetur armë zjarri të cilat pas verifikimit ka rezultuar se janë vjedhur apo humbur në shtetet fqinje apo më larg.

Sipas statistikave policore, në vendin tonë gjatë viteve 2019-2021, janë regjistruar 51 raste të veprës penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse", ndërsa për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" janë raportuar 3856 raste.

Numri më i madh i rasteve me kontrabandë dhe posedim ilegal të armëve dhe municionit është në hyrje të Kosovës me Shqipërinë, megjithëse kjo dukuri paraqitet edhe në kufirin me Malin e Zi dhe Serbinë, por në numër dhe sasi më të vogël.

Në vendin tonë, armët me gaz vijnë kryesisht nga Turqia dhe Bullgaria, përmes Maqedonisë, duke shfrytëzuar rrugët tokësore, dhe Kosova në shumë raste përdoret vetëm si vend transit, për të vijuar më tutje në drejtim të Evropës Perëndimore përmes Serbisë, Shqipërisë, Malit të zi etj.

Trafikantët bëjnë transportimin e armëve dhe municionit me autobus, me vetura, në këmbë etj., duke shfrytëzuar pikë kalimet kufitare por edhe përmes zonave malore të vijës së gjelbër kufitare.

Dukuri e re në Kosovë, është trafikimi përmes postës ose blerjet 'online', ku vitin e fundit janë zbuluar disa raste të blerjeve 'online', kur individ të caktuar kanë tentuar të përdorin postën për të sjellë në Kosovë armë ose pjesë të armëve të blera 'online', nga vende të ndryshme, por kryesisht në Kinë.

Janë regjistruar raste, kur këto armë gazi, trafikantët kanë tentuar që t'i fusin në Kosovë me veturë të postës së shpejtë prej Serbisë.

Armët e vërteta të zjarrit, në bazë të origjinës së armëve që janë konfiskuar, besohet se vijnë nga Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Sllovakia, Zvicra, Çekia, etj. Po ashtu, ka raste kur disa nga armët e konfiskuara në Kosovë, pas gjurmimeve ndërkombëtare, kanë rezultuar që herën e fundit janë shitur legalisht në SHBA, pastaj pistoleta të tjera të



konfiskuara të prodhimit jugosllav, të cilat pas hetimit kanë rezultuar se kanë qenë të lajmëruara si të humbura/vjedhura në Afrikën e Jugut.



Rrugët hyrëse dhe dalëse të trafikimit të armëve në Kosovë

Nuk ka të dhëna se këto armë, janë sjellë në vendin tonë nga grupe të organizuara kriminale, por kryesisht nga individ të caktuar që jetojnë në këto vende, për përfitime materiale apo edhe për posedim personal.

Një sasi e armëve të zjarrit të llojit 'AK-47', armëve të gjahut dhe municionit për armët e gjahut, trafikohen nga Shqipëria në Kosovë, në rajonin e Prizrenit por edhe në rajonet e tjera përgjatë kufirit me Shqipërinë.

Në anën tjetër, nga Republika e Kosovës për në Republikën e Shqipërisë, bëhet kontrabandim i armatimit të kalibrit të vogël, revoleve, të cilat sillen kryesisht nga Serbia.

Në rajonin e Gjakovës, armët që trafikohen nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas, kryesisht bëhen përmes rrugëve ilegale afër pikëkalimeve kufitare.

Në kuadër të Planit të Veprimit të BE-së Kundër Trafikimit të armëve të zjarrit 2020-2025, parashihet që gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, ku bën pjesë edhe Kosova, të kenë legjislacion, juridiksion dhe kapacitete administrative dhe institucionale, në harmoni të plotë me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian (BE), për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta të zjarrit, ndalimin e posedimit, keqpërdorimin dhe trafikimin ilegal të tyre në mënyrë që ky rajon të bëhet më i sigurt.


Gjurmimi i armëve, që ka të bëjë me hetimin sistematik të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe municionit, prej prodhuesit deri tek blerësi i fundit, ndihmon organet kompetente vendore dhe ndërkombëtare, në hetimet e të gjitha rasteve të krimeve që ndërlidhen me armë, veçanërisht në rastet e lidhura me prodhimin dhe trafikimin e kundërligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve të saj dhe municionit si dhe ndihmon në identifikimin e kanaleve të furnizimit të trafikimit të kundërligjshëm.

Aktualisht, është domosdoshmëri që Policia e Kosovës të bëhet anëtare e INTERPOL-it, për të përfituar dhe për të kontribuar në sigurinë lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, sepse vendi ynë ballafaqohet me krime të ndryshme, ku përfshihen edhe çështje e raste që shtrihen përtej juridiksionit të institucioneve kosovare.

Armët ilegale dhe municioni i konfiskuar

Numri i armëve ilegale në duart e popullatës kosovare, vazhdon të jetë i lartë. Policia e Kosovës vazhdon të luaj një rol vendimtar në reduktimin e armëve të paligjshme, duke bërë konfiskimin dhe heqjen nga tregu ilegal të rreth 1300-1400 armëve për çdo vit.

ARMËT DHE MUNICIONI I KONFISKUAR NË VITET 2019-2021



Edhe përkundër këtyre konfiskimeve, qytetarët kosovar kanë në posedim një numër të lartë të armëve ilegale, dhe kjo vlerësohet se paraqet kërcënim për sigurinë e qytetarëve dhe sfidë të vazhdueshme për Policinë e Kosovës dhe organet tjera të sigurisë, për të krijuar një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët.

Duke u bazuar në informacionet e raporteve policore për armët e konfiskuara për vitet 2019-2021, rezulton se armët e konfiskuara, në masë të madhe, janë armë të mbetura nga lufta e fundit në Kosovë, mirëpo viteve të fundit janë konfiskuar edhe armë të tjera të reja, armë me gaz që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë ilegale.

Të gjitha armët e konfiskuara në periudhën kohore 2019-2021, janë në total 3854 copë, prej tyre 1024 janë armë me gaz dhe 433 armë të konvertuara.



Konfiskime të ndryshme të armëve dhe municionit

Modelet më të shpeshta të armëve të konfiskuara janë: modelet 'AK-47' te pushkët automatike, modelet 'Double Barrel' dhe 'Over Under' (dy tytëshe) te pushkët e gjahut, modelet 'TT M57' dhe 'CZ 7.65' te pistoletat, modelet 'Zoraki', 'Ecol Special', 'Ecol Jackal', 'Dual Compact', 'Ecol Tuna' te armët me gaz.

Armët me gaz, të cilat konvertohen lehtësisht në armë vdekjeprurëse, janë mjaft të kërkuara në tregun ilegal të armëve dhe janë më të lira për t'u blerë. Fitimet e mëdha nga ky aktivitet që është në trend viteve të fundit, i stimulojnë trafikantët të merren me këtë dukuri negative e të rrezikshme.



Dy pistoleta të konvertuara: 'Zoraki M906-B' (mbishkrim SIG Sauer) dhe 'Zoraki 917' (me mbishkrim GLOCK 9MM).

Njëra ndër arsyet, se pse armët e konvertuara janë në trend, është se ato lehtë gjenden në treg dhe gjurmimi i tyre është i vështirë. Këto armë kryesisht prodhohen në Turqi dhe blihen me çmimin prej 60 eurove. Besohet se, ato pastaj konvertohen në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Serbi, Turqi etj.

Ndonëse, Policia e Kosovës, në vazhdimësi është aktive në konfiskimin e armëve nëpër ceremoni festive e ahengje, prapëseprapë, përdorimi i armëve të zjarrit, por dhe armëve me gaz dhe atyre të konvertuara, në këto ceremoni, si dukuri ende vazhdon të shfaqet në vendin tonë, duke cenuar sigurinë e qytetareve. Janë regjistruar disa raste, kur nga të shtënat festive, ka pasur humbje jete ose janë shkaktuar plagosje aksidentale.

Policia e Kosovës dhe mekanizmat e tjerë institucional, zhvillojnë fushata të ndryshme sensibilizuese për vetëdijesimin, ndërgjegjësimin dhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve, për pasojat e përdorimit të armëve dhe mjeteve piroteknike.

Vlerësuar në përgjithësi, Republika e Kosovës, ka bazë të mirë ligjore për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të armëve dhe kriminalitetit me armë. Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për armë, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të vogla, të lehta dhe Eksplozivëve 2017-2021, paraqesin dokumentet bazë që rregullojnë këtë fushë dhe në masën më të madhe janë në përputhje të plotë me rregullativën ligjore evropiane.

Në vendin tonë, vërehet një trend në rritje i kërkesave për blerje legale të armëve nga qytetarët. Procedura për pajisje me leje dhe licencë për armë legale, zbatohet në përputhje me Ligjin për armë dhe janë duke u implementuar standardet evropiane të gjurmimit dhe shënjitimit.

Republika e Kosovës vlerësohet lartë nga të gjitha institucionet dhe organizatat relevante të kësaj fushe, për krijimin dhe funksionalizimin e pikës kryesore të armëve (ILECU-PK), si vendi i parë në rajon që ka arritur të përmbushë këtë kriter, duke ngritur kapacitetet e inteligjencës policore dhe ndërlidhjen e saj në inteligjencën balistike për të identifikuar, analizuar dhe parandaluar të gjitha format e krimit që ndërlidhen me armë.

Policia e Kosovës, po ashtu ka marrë pjesë në operacione me karakter ndërkombëtar në fushën e luftës kundër trafikimit të armëve të quajtur JAD-(ditët e veprimit të përbashkët), operacion ky i koordinuar nga EUROPOL dhe EMPACT. Ajo merr pjesë edhe në OP "Conversus", operacion ndërkombëtar që udhëhiqet nga Policia e Rumanisë, për luftimin e trafikimit të armëve me gaz dhe atyre të konvertuara, i cili si fenomen përpos Ballkanit Perëndimor, prek edhe shtetet e BE-së.

Vendi ynë, ka bashkëpunim të mirëfilltë policor me shumicën e vendeve të rajonit dhe një numër të vendeve evropiane, në fushën e luftimit të trafikimit të armëve.

KËRCËNIMET HIBRIDE

Kërcënimet hibride janë fenomen i ri i luftës speciale e cila është prezente në Kosovë por edhe në vende të tjera.

Kërcënimet hibride të drejtuara kundër Kosovës, janë luftë e gjeneratës së re, që vështirë se mund të parandalohen pa u shkaktuar fillimisht dëmet dhe pasojat, e të cilat shkaktohen nga entitete qoftë shtete apo organizata për të arritur qëllime të caktuara pa shpallur luftë formale.

Një ndër format e kërcënimeve kundër Kosovës janë edhe sabotimet apo bojkotimet e brendshme, në nivelin qendror apo lokal, që paraqesin kërcënime ndaj rendit kushtetues të Kosovës.



Kërcënimet hibride ndaj Kosovës janë të fokusuara në gjetjen dhe shfrytëzimin e dobësive të shoqërisë dhe shtetit tonë, për të minuar demokracinë, të arriturat, për të penguar fuqizimin e shtetit, shtrirjen e funksionalitetit të plotë në tërë territorin me qëllim që vendi ynë të bëhet jo funksional si shtet dhe i dështuar.

Kosova edhe në të ardhmen mund të ekspozohet nga më shumë kërcënime hibride të cilat mund ta shfrytëzojnë çdo cenueshmëri, përfshirë këtu edhe cenueshmërinë e sigurisë në pjesën veriore të vendit, pakënaqësitë sociale, aspektet ideologjike, krizat energjetike, apo cenueshmëri të tjera.



Kërcënim real hibrid paraqesin edhe lajmet e rreme me tendenca të caktuara, ku duke e shfrytëzuar teknologjinë e avancuar shpërndahen shumë lehtë tek audiencia e targetuar. Si pasojë e kësaj, shpeshherë faktet dhe lajmet e rreme, me vështirësi dallohen dhe verifikohen.

KRIMET MJEDISORE

Krimet mjedisore janë krime që konsiderohen me pak shkelës dhe me shumë viktime.

Në Kosovë, viteve të fundit gjithnjë e më shumë, si objekt referues i sigurisë është duke u trajtuar edhe mjedisi me elementet e tij përbërëse. Prandaj, ndryshimet mjedisore dhe rreziqet e kërcënimit ndaj tij, vlerësohen si rreziqe dhe kërcënime ndaj sigurisë mjedisore e në këtë kontekst edhe kërcënime ndaj sigurisë së përgjithshme kombëtare dhe më gjerë.

Policia e Kosovës bashkë me zyrtarë nga MMPHI dhe KPMM, gjatë vitit 2019 kanë zbatuar plan të gjerë për parandalimin dhe ndalimin e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare me ç' rast në terren janë identifikuar mangësi të madha në përmbushjen e kushteve në bazë të standardeve ligjore të kërkuara nga operator të licencuar si dhe janë hasur edhe operator të pa licencuar.

Gjithashtu gjatë zbatimit të planit është konstatuar edhe problematika tjetër që ka qenë mungesa e veprimtimit të operatorëve konform kushteve të lejes/licencës dhe standardeve të kërkuara për siguri në punë dhe mbrojtjes së mjedisit nga ndotja dhe degradimi.

Në bazë të gjetjeve në terren vlerësohet se situata nuk është e mirë dhe është konstatuar se ka degradim të ambientit në përgjithësi në shumë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Shumë prej gurëthyesve, janë duke e rrezikuar florën dhe faunën, me anë të gërmimeve në shtretërit dhe brigjet e lumenjve si dhe në bjeshkët/kodrat e caktuara edhe pse posedojnë leje të lëshuara nga autoritet e shtetit. Këto kompani gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre nuk e kursejnë florën dhe faunën si dhe ambientin përreth. Përveç që këto kompani merren me përpunimin e gurit, ato ndotin ambientin edhe përmes ujërave të zeza.

Në këto ujëra të zeza hyjnë edhe mbetjet nga mirëmbajtjet e mjeteve motorike, ndërrimi i vajit, larja e tyre, në disa raste këto kompani mbeturinat i derdhin edhe në lumenjtë më të afërt.

Ndër ndotësit e mëdhenj të ambientit janë edhe fabrikat për prodhimin e stiropolit, ngjyrave, fabrikat për përpunimin e drurit (peletit), e që në Kosovë ka disa prej tyre. Disa nga këto fabrika, mbetjet kimike nuk i kanë të siguruara në mënyrë adekuate dhe në disa raste derdhja e tyre bëhet nëpër lumenj dhe në kanalizimet e qyteteve apo fshatrave duke rrezikuar seriozisht tokën pjellore, florën dhe faunën.

Aspekti tjetër shqetësues në ndotjen e ambientit janë edhe barnatoret si dhe kompanitë farmaceutike. Kosova ka numër të madh të barnatoreve ndërsa edhe më tutje problematike mbetet shkatërrimi i barnave të cilave ju skadon afati i përdorimit pasi që ende ka probleme me shkatërrimin e tyre për shkak të mungesës së fabrikave të tilla.

Ekziston dyshimi se pronarët e barnatoreve, në mungesë të ndonjë vendi adekuat për shkatërrimin e barnave me afat të skaduar i përziejnë ato barna me mbeturina ditore të cilat mblidhen nga kompanitë e pastrimit të qytetit.

Problematikë tjetër mbetet edhe gjuetia ilegale e cila është po ashtu një fenomen mjaft i përhapur. Në vazhdimësi nga viti në vit kemi rritje të numrit të gjahtarëve dhe numër më të madh të personave të pajisur me leje për armë gjahu. Edhe pse gjuetia në Kosovë është e rregulluar me ligj dhe i ka sezonet e lejuara dhe ndaluara si dhe kushtet e përcaktuara për gjueti, ajo prapë është duke u keqpërdorur nga persona të pa ndërgjegjshëm të cilët me veprimet e tyre janë duke e dëmtuar në masë të madhe faunën kombëtare përmes gjahut ilegal. Policia ka trajtuar disa raste kur janë vrarë kafshët e mbrojtura me ligj, për të cilat informacionet janë siguruar nga publikimet në rrjetet sociale por ka qenë i vështirë identifikimi i lokacioneve se ku janë vrarë ato kafshë.

Ndotja e lumenjve përgjatë shtrirjes së tyre është duke ndodhur për shkak të derdhjes së ujërave të zeza dhe mungesës së kolektorëve, për shkak të hedhjes së mbetjeve nga disa fabrika të qumështit, mbetjeve nga disa fabrika tjera, nga hedhja e mbeturinave etj. Kjo ndotje konsiderohet mjaft e lartë dhe mund të verifikohet lehtë.



Foto nga ndotja e lumenjëve në Kosovë

Problematikë tjetër e theksuar në Republikën e Kosovës është gjendja me deponitë e mbeturinave. Deponitë e mbeturinave sanitare aktuale, nuk i plotësojnë kushtet themelore për funksionimin e tyre.

Mos përfillja e standardeve të kërkuara, vendosja e sistemit të ajrosjes për lirim të metanit (gazrave), mosfunksionimi i stacioneve të pompimit (ujërave që derdhen nga deponia, kthimi i tyre në deponi dhe avullimi i tyre në hapësirë), rreziku që këto ujëra të rrjedhin në ujërat nëntokësore që do të shkaktonte edhe ndotjen dhe helmimin e mundshëm të ujërave nëpër puse, paraqet një rrezik të madh për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës edhe pse deri më tani nuk është konstatuar për ndonjë ndotje të tillë.

Prerjet ilegale të pyjeve janë dukuri mjaft e përhapur në Kosovë dhe kërcënim i drejtpërdrejtë i parqeve kombëtare si dhe maleve në pronësi shtetërore. Ky fenomen është duke e rrezikuar florën dhe faunën si dhe duke krijuar rrethana për shpeshimin e katastrofave natyrore, zvogëlimin e reshjeve dhe rritjen e thatësisë. Prerja e drunjëve është duke ndodhur për ngrohje si dhe për përpunim në industri. Sa i përket shkretërimit të pyjeve, drunjtë e prerë, transportohen ilegalisht dhe stërshiten në treg ose dërgohet drejtë te klientët e caktuar.

Po ashtu pyjet janë duke u dëmtuar në masë të madhe edhe nga djegia sidomos gjatë periudhës së ngrohtë, nga pakujdesia e qytetarëve dhe zjarrvëniet e qëllimshme.

Foto nga djegia e pyjeve në Kosovë



Kosova ka një bazë të mirë ligjore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit ku vetëm në Kodin Penal i ka 18 vepra penale të cilat ndërlidhen edhe me Ligjin për miniera dhe minerale, Ligjin për ndërtimet, Ligjin për mbrojtjen e natyrës, Ligjin për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis, Ligjin për vlerësim strategjik mjedisor, Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për

ujërat. Po ashtu Kosova, lidhur me këtë problematikë ka Strategji Shtetërore për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022 si dhe Plan të Veprimit.

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

BE - Bashkimi Evropian

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit

DHKO (SHKK) - Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar (Sektori i Hetimeve të Krimeve Kibernetike)

DSHAM - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme

DPI - E Drejta e Pronësisë Intelektuale

EUROPOL - Organizata Policore Evropiane

EMPACT - Platforma Multidisiplinare Evropiane kundër Kërcënimeve Kriminale (European Multidisciplinary Platform Against Criminal Threats)

INTERPOL - Organizata Policore Ndërkombëtare

ILECU - Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit në PK

IPA 2019 - Countering Serious Crime in the Western Balkans - Luftimi i Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor

JAD - Ditët e Veprimit të Përbashkët (Joint Action Day EUROPOL)

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

KPMM - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe minerale

NJIF-K - Njësia e Inteligjencës Financiare në Kosovë

NJVH - Njësia e Veçantë e Hetimeve PK

OJQ - Organizatë Joqeveritare

POS - Pajisje për Pranim dhe Përpunim të Pagesave në pika të shitjes (Point of sale)

PSRK - Prokuroria Speciale e Kosovës

QKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës

SIENA - Aplikacioni i Rrjetit të Sigurt të Shkëmbimit të Informacionit në Organizatën Policore Evropiane (Secure Information Exchange Network Application/ EUROPOL)

SOCTA - Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda (Serious and Organised Crime Threat Assessment)

TRANSPARENCY INTERNATIONAL - Organizatë Joqeveritare Ndërkombëtare që njihet si lëvizje globale kundër korrupsionit.